



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1988/7 prot.

Datë 25.08.2026

V E N D I M
Nr. 1031/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gjergj Mersini	Nënkryetar
Edvin Simo	Anëtar
Donika Daci	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.08.2026 me,

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kreatx” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-83473-04-27-2026, me objekt: “*Shpenzime për procesin e fiskalizimit për faturat*”, me fond limit 10,980,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 21.05.2026 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjetllës Kanalizime Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: SH.A Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, me adresë: Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Kreatx” SHPK me NIPT (L12121023B) dhe adresë: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Robert Zhvarc”, Godina Niku Konstruksion, Kati 1 Teknik, Hyrja Nr, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021

“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.04.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-83473-04-27-2026, me objekt: “Shpenzime për procesin e fiskalizimit për faturat”, me fond limit 10,980,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 21.05.2026 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjellës Kanalizime Tiranë.

II.2. Në datën 21.05.2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më

datë 05.06.2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Kreatx” SHPK	8,235,000 lekë	Skualifikuar
2. “Prisma” SHPK	10,100,000 lekë	Kualifikuar
3. “Soft Solution” SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike	

II.4. Në datën 12.06.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi Paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Konkretisht operatori ekonomik “Kreatx” SHPK rezulton i skualifikuar për arsyet si më poshtë:

“2.Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Kreatex me ofertë 8.235.000 (tete milion e dyqind e tridhjetë e pese mije) lekë pa tvsh.

Se pari Ak në dokumentat standarte te tenderit perkatesisht ne piken 2.5 te kriterave te vecante te kualifikimit ka kekruar si me poshte vijon:

2.5 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për objektin e prokurimit me prodhuesin e sistemeve të specifikuar si mëposhte:

- Për Programin Kompjuterik te faturimit, te perdorur nga UKT i cili kerkohet te integrohet;*
- Për Programin Kompjuterik ETL/DataIntegration, i cili do te ofertohe;*

Autorizimi i prodhuesit kerkohet te jete specifik per kete procedure prokurimi, duhet te drejtohet AK dhe te permbaje referencat e procedures. Dokumenti i autorizimit duhet te permbaje kontraktet telefon, email apo tjeter te prodhuesit/distributorit te autorizuar ne menyre qe te mundesoje AK verifikimet e nevojeshme.

Gjatë verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se operatori ekonomik nuk e ka përmbushur kërkesën e përcaktuar në pikën 2.5 të Dokumenteve Standarde të Tenderit, si në aspektin formal ashtu edhe në atë substancial. Kriteri në fjalë nuk është formuluar në mënyrë të përgjithshme për paraqitjen e një zgjidhje faturimi apo të një sistemi ekuivalent, por lidhet drejtpërdrejt me programin ekzistues të faturimit në përdorim nga UKT, i cili përbën platformën bazë me të cilën duhet të integrohet zgjidhja e kërkuar në kuadër të kontratës. Për këtë arsye, autorizimi nga prodhuesi i këtij sistemi përbën një kërkesë thelbësore dhe të domosdoshme për kualifikimin e operatorit ekonomik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizimin e kërkuar nga prodhuesi i sistemit ekzistues të faturimit. Ky autorizim përbën provën që operatori ekonomik disponon të drejtat e nevojshme ligjore dhe teknike për të ndërvepruar, integruar dhe realizuar ndërhyrje në një sistem që është në pronësi ose nën të drejtat e autorit të një subjekti të tretë. Mungesa e tij nuk mund të zëvendësohet me deklarime të vetë operatorit ekonomik apo me paraqitjen e një sistemi alternativ të zhvilluar prej tij, pavarësisht pretendimeve për ekuivalencë teknike. Paraqitja e një sistemi tjetër nga operatori ekonomik dëshmon një keqinterpretim të kërkesës së DST-së, pasi objekti i procedurës nuk konsiston në zëvendësimin e sistemit ekzistues

të faturimit të UKT-së, por në integrimin me të. Për rrjedhojë, oferta e paraqitur devijon nga kërkesa themelore e dokumenteve të tenderit dhe nuk i përgjigjet objektit të kontratës së prokuruar. Kjo mospërputhje nuk mund të konsiderohet si mangësi formale apo e korrigjueshme, por përbën një devijim material nga kërkesat e DST-së, duke cenuar parimin e përgjegjshmërisë së ofertës. Një ofertë konsiderohet e përgjegjshme vetëm kur përmbush plotësisht kërkesat e dokumenteve të tenderit, pa ndryshuar natyrën e objektit të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu, mungesa e autorizimit nga prodhuesi i sistemit ekzistues krijon pasiguri serioze lidhur me respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të pronësisë intelektuale mbi programin me të cilin kërkohet integrimi. Pa një autorizim të tillë nuk ekziston asnjë garanci që ndërveprimi, integrimi, shkëmbimi i të dhënave apo ndërhyrjet teknike mbi sistemin ekzistues do të realizohen në përputhje me të drejtat e mbajtësit të tyre, duke ekspozuar autoritetin kontraktor ndaj rreziqeve ligjore, teknike dhe operationale.

Po ashtu, mungesa e autorizimit cenon sigurinë dhe realizueshmërinë e kontratës gjatë gjithë periudhës së zbatimit të saj. Integrimi me një sistem ekzistues kërkon jo vetëm akses fillestar, por edhe mbështetje të vazhdueshme teknike, bashkëpunim institucional dhe disponueshmëri të informacionit teknik nga prodhuesi ose mbajtësi i të drejtave. Në mungesë të autorizimit përkatës, nuk ekziston garancia se operatori ekonomik do të ketë aksesin dhe mbështetjen e nevojshme për të realizuar me sukses integrimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e qëndrueshëm të zgjidhjes gjatë afatit kontraktor. Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se operatori ekonomik nuk ka provuar disponimin e të drejtave dhe autorizimeve të nevojshme për të realizuar integrimin me sistemin ekzistues të faturimit të UKT-së dhe, rrjedhimisht, nuk garanton përmbushjen e detyrimeve kontraktore në përputhje me kërkesat e Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Se dyti Ak në dokumentat standarte të tenderit perkatesisht në piken 2.6 të kriterëve të vecantë të kualifikimit ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.6 Operatorët ekonomikë duhet të zoterojë aftësitë/certifikimet për veprimtaritë dhe teknologjitë si mëposhte:

- Për Fiskalizimin e Fatures. Zgjidhja softëware-ike e ofertuar duhet të jetë e certifikuar për veprimtarinë e fiskalizimit, si mëposhte:

- Me dhe pa para në dorë;
- Pa para në dorë, e-invoice;
- Faturë shoqëruese;

- Për Sisteme Cloud, në platformën e cila do të ofertohej. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga Drejtoria e Tatimeve dhe AKSHI, prodhuesit e programeve dhe teknologjive që po ofertojnë, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara nga prodhuesit për dhënien e tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se operatori ekonomik Kreatx nuk ka provuar përmbushjen e kriterit 2.6 të Dokumenteve Standarde të Tenderit. Kriteri 2.6 përbën një kriter kualifikimi me karakter formal dhe detyrues, i përcaktuar në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë, sipas

të cilit kërkohet paraqitja e certifikimeve të lëshuara nga prodhuesit e programeve dhe teknologjive që do të ofrohen, ose nga autoritete të autorizuar prej tyre, për sistemet Cloud dhe platformën teknologjike që do të përdoret për realizimin e kontratës. Ky kriter është vendosur nga Autoriteti Kontraktor për të garantuar që infrastruktura Cloud, shërbimet e hostimit dhe operimi i sistemit të realizohen në mënyrë të autorizuar, të certifikuar dhe në përputhje me standardet teknike dhe ligjore të kërkuara. Rëndësia e tij është argumentuar edhe në dokumentacionin e miratimit të kriterëve të kualifikimit, duke qenë se objekti i kontratës lidhet drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve Cloud ku do të përpunohen, transmetohen dhe ruhen të dhëna operative, konfidenciale dhe të dhëna personale.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se operatori ekonomik nuk ka depozituar certifikimet e kërkuara në DST, por ka paraqitur vetëm një deklaram të vetin, të shoqëruar me referenca në faqe interneti, duke pretenduar se prodhuesi apo ofruesi i platformës nuk aplikon politika certifikimi për partnerët ose përdoruesit e shërbimit. Komisioni vlerëson se një deklaram i tillë nuk përbën dokumentacion provues dhe nuk mund të konsiderohet i barasvlershëm me certifikimet e kërkuara shprehimisht nga Dokumentet e Tenderit. Kërkesa e DST-së është e qartë dhe kërkon paraqitjen e dokumenteve zyrtare të lëshuara nga prodhuesi ose nga autoritete të autorizuar prej tij. Për rrjedhojë, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik nuk përmbush formën dhe përmbajtjen e provës së kërkuar, duke rezultuar në mosplotësim të kriterit të kualifikimit. Gjithashtu, Komisioni vlerëson se kriteri në fjalë lidhet drejtpërdrejt me garantimin e ligjshmërisë, sigurisë dhe vijueshmërisë së shërbimit Cloud që do të ofrohet gjatë zbatimit të kontratës. Certifikimi ose autorizimi nga prodhuesi përbën një garanci objektive se operatori ekonomik disponon të drejtën, kapacitetin teknik dhe mbështetjen e nevojshme për të administruar dhe operuar platformën Cloud në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme.

Mungesa e këtyre certifikimeve krijon pasiguri të konsiderueshme lidhur me:

- ligjshmërinë e përdorimit dhe ofrimit të platformës Cloud;
- disponimin e të drejtave për administrimin dhe konfigurimin e shërbimit;
- aksesin në mbështetjen teknike zyrtare të prodhuesit;
- mundësinë e ndërhyrjeve teknike, përditësimeve dhe zgjidhjes së problematikave gjatë periudhës së kontratës;
- garantimin e vazhdimësisë dhe sigurisë së shërbimit për Autoritetin Kontraktor.

Nga ana tjetër, Komisioni vlerëson se kriteret e kualifikimit janë kriterë formale dhe objektive, të cilat duhet të provohen përmes dokumentacionit të kërkuar në momentin e paraqitjes së ofertës. Përmbushja e tyre nuk mund të bazohet në deklarime të njëanshme të operatorit ekonomik dhe as të zëvendësohet me interpretime apo verifikime të mëvonshme nga Autoriteti Kontraktor. Barra e provës për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit i takon ekskluzivisht operatorit ekonomik. Kërkesa që Autoriteti Kontraktor të kryejë verifikime të jashtme pranë prodhuesit të platformës Cloud ose të ndërmarrë hetime shtesë për të provuar ligjshmërinë e përdorimit të shërbimit do të binte në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë, duke krijuar një avantazh të padrejtë për ofertuesin në fjalë në raport me pjesëmarrësit e tjerë të procedurës. Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave arrin në përfundimin se

operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin provues të kërkuar për kriterin 2.6 dhe nuk ka demonstruar në mënyrë të mjaftueshme, objektive dhe të verifikueshme përmbushjen e këtij kriteri.

Se treti: Ak në dokumentat standarte të tenderit perkatesisht në piken 2.7 të kriterëve të vecantë të kualifikimit ka kërkuar si më poshtë vijon:

Kërkesa 2.7. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, prej të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të angazhohet në realizimin e shërbimeve objekt kontrate, si më poshtë: d) 1 (një) punonjës të certifikuar për sisteme BI, për platformën që do të përdoret, përcaktuar në terma të references (Oracle Analytics ose 'equivalent'). Komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon se thelbi i këtij kriteri nuk është vetëm që operatorin të disponojë staf me njohuri të përgjithshme në IT, por që të provojë se ky staf është i certifikuar në mënyrë specifike, të drejtpërdrejtë dhe në përputhje me teknologjitë dhe sistemet konkrete të kërkuara nga DST, duke garantuar realizimin e kontratës pa rrezik teknik apo funksional. Komisioni i vlerësimit të ofertave nga verifikimi i dokumentacionit teknik dhe certifikimeve të paraqitura, rezulton se operatorin ekonomik nuk ka arritur të provojë në mënyrë të plotë dhe të besueshme përmbushjen e këtij kriteri, për arsye si më poshtë: Në përgjigje të kësaj kërkesë për personel të Certifikuar në platforme BI (referuar formularit të vetë deklaramentit) paraqiten :

- transcript të Microsoft për Microsoft Certified Solution Associate BI Reporting (të cilat datojnë kohë më parë) por jo një certifikatë në Microsoft për platforma BI, si dhe
- certifikata Business Intelligence (BI) të përgjithshme (pa një teknologji apo produkt Oracle Analytics apo një produkt 'equivalent') të lëshuara nga VsKills; apo
- Certifikata në OXANA BI; në Oxana AI Floëgram; në Oxana DataSource Builder; në Oxana Report Builder (pa një teknologji apo produkt Oracle Analytics apo një produkt 'equivalent') të lëshuara nga vete OE. Në mënyrë të vecantë, OE në përgjigje të kësaj kërkesë nuk paraqet argumenta që produkti Oxana, mundet të jetë equivalent me platformën ekzistuese Oracle Analytics. Gjejmë me vend të theksojmë se platforma Oracle Analytics, është një platformë ndërkombëtare e mirëpranues si leader botëror në këtë fushë me prezencë të gjere në kompani Utilitare, dhe në ofertën teknike të OE nuk gjejmë asnjë argument, apo reference, raport ndërkombëtare apo të një pale të trete të besueshme që mundet të mbështesë equivalencën. Në kuptim të nenit 77 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik", kapaciteti teknik dhe profesional duhet të provohet me mjete të përshtatshme, të verifikueshme dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nuk arrin të plotësojë këtë standard, pasi nuk demonstroi në mënyrë të qartë përputhjen midis certifikimeve të paraqitura dhe kërkesave specifike të DST. Në përfundim të sa më sipër, konstatohet se operatorin ekonomik nuk ka arritur të provojë disponimin e një stafi të certifikuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kriterin 2.7 të DST. Mungesa e certifikimeve specifike për sistemet e kërkuara, niveli i pamjaftueshëm i certifikimeve cloud dhe databazë, si dhe përdorimi i certifikimeve të brendshme pa vlerë të pavarur verifikuese, përbëjnë mosplotësim të një kriteri thelbësor të

kualifikimit. Për rrjedhojë, operatori ekonomik nuk plotëson kriterin 2.7 të Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe oferta e tij konsiderohet e pakualifikueshme.

Se katerti :Ak në dokumentat standarte të tenderit perkatesisht ne piken 2.8 te kriterave te vecante te kualifikimit ka kekruar si me poshte vijon:

2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, lidhur me produktet softëare/komjuterike të gatshëm duhet të paraqesë materiale/kataloge/datasheet teknike të prodhuesve. Katalogjet teknike kerkohen per produktet standarde te ofruara, minimalisht per sistemin e fiskalizimit, si dhe ETL/DataIntegration te ofertuar; Në zbatim të kërkesës së përcaktuar në pikën 2.8 të DST, u shqyrtua dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik për paraqitjen e materialeve/katalogëve/datasheet teknike të prodhuesit për produktet standarde softëare, konkretisht për sistemin e fiskalizimit dhe për komponentin ETL/DataIntegration. Komisioni I vleresimit të ofertave nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se operatori ekonomik ka dorëzuar materiale të titulluara si katalog produkti për zgjidhjen Oxana ETL/Data Integration & BI. Megjithatë, këto materiale nuk përmbushin në mënyrë substanciale kërkesën e DST për katalogje teknike të prodhuesit, për arsytet si më poshtë:

Së pari: Dokumentet e paraqitura nuk rezultojnë të jenë katalogë teknikë të standardizuar apo datasheet të prodhuesit, të cilat zakonisht përmbajnë specifika të verifikueshme teknike, parametra funksionale, versione, arkitekturë të standardizuar, kërkesa infrastrukturore dhe dokumentim teknik të strukturuar. Në vend të kësaj, dokumentet janë të përpiluara në formë përshkrimi narrativ dhe tabelor për nevoja të procedurës konkrete të tenderit, duke deklaruar shprehimisht se shërbejnë si “material produkti për dokumentacionin teknik të tenderit”. Duke konfirmuar që nuk kemi të bëjmë me një produkt standard, por me një material apo zgjidhje të përgatitur posaçërisht për këtë procedurë.

Së dyti, në lidhje me komponentin më kritik, ETL/DataIntegration, rezulton një problem edhe më thelbësor. Dokumenti i paraqitur për “Oxana ETL/Data Integration & BI” është një material i hartuar për këtë tender, i cili:

- deklaron vetë qëllimin si “evidentimi i përputhshmërisë me kërkesat e tenderit”;
- përshkruan zgjidhjen në kontekstin specifik të UKT dhe integritet me sistemet e saj (, Oracle DËH, OAC);
- paraqet një matricë përputhshmërie ku vetë produkti vlerëson përmbushjen e kërkesave të tenderit.

Ky lloj dokumenti nuk përbën një datasheet teknik të një produkti standard në treg, por një material të personalizuar për këtë procedurë, i cili nuk garanton karakterin e një produkti të gatshëm dhe të verifikueshëm në mënyrë të pavarur. Më tej, nga përmbajtja e dokumentit rezulton se komponenti ETL paraqitet si një kombinim i moduleve të zhvilluara nga vetë operatori (Floëgram, Data Source Builder, Report Builder, BI), të cilat përputhen edhe me analizën e mëparshme mbi certifikimet dhe autorizimet, ku konstatohet se kemi të bëjmë me një zgjidhje të brendshme të operatorit dhe jo me një produkt të standardizuar nga një prodhues i njohur. Kjo përforcon faktin që katalogu i paraqitur nuk është dokument teknik i një produkti të standardizuar në kuptimin e DST. Në aspektin juridik dhe procedural, sipas nenit 77 dhe 78 të ligjit nr.162/2020 “Për

prokurimin publik”, dëshmia e kapaciteteve teknike duhet të bëhet përmes dokumenteve të besueshme, të verifikueshme dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Në këtë rast, materialet e paraqitura nuk plotësojnë këtë standard, pasi:

- nuk janë dokumente standarde të prodhuesit,
- nuk janë të pavarura nga operatori ekonomik
- nuk mundësojnë verifikim objektiv teknik nga Autoriteti Kontraktor.

Në përfundim, vlerësohet se operatori ekonomik nuk ka përmbushur kriterin 2.8 të DST, pasi dokumentacioni i paraqitur nuk përbën kataloge apo datasheet teknike të prodhuesit në kuptimin e kërkuar nga dokumentet e tenderit.

Se Ak në dokumentat standarte të tenderit perkatesisht ne shtojcen nr 2 ka kekruar si me poshte vijon:

Shtojca 2.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik) LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT Data: Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

_____ Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit
Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):
_____ Monedha: _____ Në rast

të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë. Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë. Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t’u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve 1 2 3 4 5 6

Art. Përshkrimi i shërbimit Sasia Njesia Çmimi për njësi Çmimi total për shërbime (3 x 4)

1. Hostimi si dhe sistemi i fiskalizimit, e-fatures dhe fatures se transportit per periudhen e kontrates. Perfshire

- nderfaqe API per fiskalizimin automatik nga sistemet e brendshme.

- Versioni ëeb, dhe mobile Apps. 1 Set

2. Hostim, zbatimi i modulit shkembimit ETL/Data Integration per sinkrinizimit e popullimin e te dhenave. Zhvillimi i raportimeve ne sistemi BI per procesin e fiskalizimit dhe integritimit. 1 Set

3. Sistemi i leshimi i faturave manuale ne zyrat dhe zonat e UKT (per minimum 80 Users); 1 Modul

4. Sistemi i miratimit te faturave ne blerjen, ne nje ëorkfloë me minimalisht 3 hapa / aprovime. 1 Modul

5 Trajninin e perdoruesve te sistemit.

2 Klasa

6 Mirëmbajtja dhe support Sherbimi i suportit dhe mirembajtjes per ceshtje teknike dhe operacionale. 2 Vite

Gjatë verifikimit të dokumentacionit në SPE Komisioni I Vlerësimit të ofertave konstaton se në ofertën për shërbimin “Sistemi ETL/Data Integrimi” (Zëri 2: “Hostim, zbatim i modulit ETL për sinkronizim dhe popullim të të dhënave”), sipas DST vërehen këto mangësi:

- Nuk janë paraqitur katalogët standardë të produktit, sipas pikës 2.8 të kërkesave;
- Nuk specifikohet hostimi i Oxana ETL/DataIntegrator dhe mungon sqarimi për integrimin me platformat ekzistuese (OCI, Oracle EE 19c, Oracle Linux, OADB), si dhe respektimi i kërkesës që përpunimi të mos dalë jashtë tenantit Oracle OCI të UKT.

Oferta teknike paraqitet si zgjidhje e personalizuar (konfigurim, ëorkfloë, integrim, raportim), ndërsa kjo kërkon një sistem të gatshëm, të certifikuar nga AKSHI ose DPT, pa ndryshime thelbësore në kodin bazë të platformës” pra pa zhvillime shtesë për UKT.

Në mungesë të katalogut të ETL/DataIntegrator, nuk mund të vlerësohen kërkesat bazë, veçanërisht për sigurinë (ambientet prod/test/dev, aksesin në të dhëna), integrimin me teknologjitë aktuale dhe vendndodhjen e sistemit, si edhe ndërveprimi me sisteme të jashtme. Për rrjedhojë, nuk mund të bëhet një vlerësim objektiv i përmbushjes së specifikimeve teknike, pasi Autoriteti Kontraktor nuk ka bazë të mjaftueshme dokumentare për të verifikuar zgjidhjen dhe kapacitetin e operatorit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtim i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.”

II.5. Në datën 19.06.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/6853, datë 19.06.2026 dhe me nr. protokoli 1988/2026 datë 22.06.2026 e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij ekonomike. Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon:

“[...]

4.1 Formalitetet e ankimit administrativ të Kreatx SHPK.

Së pari: Në lidhje me juridiksionin e çështjes administrative në fjalë, i bëjmë me dije AK dhe KPP, se çështja përkatëse bën pjesë për shqyrtim në juridiksionin administrativ të apelimit, për sa kohë që sipas nenit 22 të KPA, ankimi administrativ për mosmarrëveshjet e prokurimit publik trajtohet vetëm nga organet e administratës publike brenda juridiksionit administrativ, fillimisht nga autoriteti kontraktor me KSHA e më pas nga KPP.

Së dyti: Për sa i përket kompetencës lëndore dhe tokësore, në zbatim të nenit 3, pika 5 dhe nenit 22, pika 2, të KPA, çështja konkrete administrative shqyrtohet fillimisht nga AK, e më pas nga KPP, pasi LPP dhe RRPP kanë parashikuar këto dy organe publike kompetente nga ana lëndore dhe tokësore për trajtimin e ankesave administrative të OE. LPP e parashikon kompetencën

lëndore dhe tokësore të AK dhe KPP në nenet 109 e në vijim të tij. Po ashtu, edhe RRPP e parashikojnë mundësinë e ankimit administrativ në nenet 94 e në vijim të tyre.

Së treti: Sa i takon afateve të paraqitjes së ankimit administrativ përpara AK dhe KPP, në këtë rast gjen zbatim pika 1, e nenit 110, të LPP dhe neni 97 i RRPP, që sanksionojnë se ky afat është 7 ditor për procedurat e prokurimit publik me vlerë nën kufirin e lartë monetar, siç rezulton që të jetë kjo procedurë prokurimi. Kështu, për sa kohë që njoftimi paraprak i fituesit është publikuar më datë 12.06.2026 në SPE dhe llogaritja e afateve bëhet në ditë sipas nenit 56 të KPA, duke përjashtuar nga afati 7 ditor i ankimit ditën që kryhet njoftimi në SPE (dita që ka ndodhur ngjarja), atëherë afati i ankimit nis të llogaritet nga e nesërme e njoftimit të vlerësimit në SPE më datë 13.06.2026 duke përfunduar më datë 19.06.2026. Theksojmë se kjo mënyrë e përlllogaritjes së afateve të ankimit gjen mbështetje sa në praktikën administrative të KPP, të ndryshuar pas muajit maj të vitit 2025, ashtu edhe në praktikën gjyqësore të KAGJL për rastet e prokurimit publik.

Argumentimit të mësipërm i vijnë në ndihmë edhe përcaktimet e pikave 9 dhe 10, të nenit 7, të vendimit nr.285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik , të ndryshuar (RRPP), që përcaktojnë se afatet kundër çdo njoftimi në SPE nisin të përlllogariten nga dita e nesërme e publikimit të tij në SPE. Për këtë qëllim, ju njohim me përmbajtjen e këtyre dy dispozitave të RRPP si vijon: 9. Për të gjitha njoftimet që bëhen sipas LPP-së dhe këtyre rregullave në sistemin elektronik të prokurimit, afatet fillojnë të përlllogariten nga dita pasardhëse e punës. 10. Afatet, kur nuk përcaktohen ndryshe në LPP dhe në këto rregulla, janë në ditë kalendarike dhe përlllogariten sipas përcaktimit në Kodin e Procedurave Administrative.

Për sa më lart, ankimi administrativ i Kreatx SHPK duhet të shqyrtohet si nga KSHA, ashtu edhe nga KPP, në situatën që ankimi administrativ është depozituar në Sistemin Elektronik të Ankesave në datën 19.06.2026, atëherë organet administrative të apelimit duhet të shprehen me vendim për të.

Së katërti: Lidhur me legjitimitetin e Kreatx SHPK për të ushtruar ankimin administrativ, në zbatim të neneve 131 e në vijim të KPA, kemi interes të ligjshëm dhe legjitimohemi për ankimin, pasi shoqëria tregtare është OE që ka marrë pjesë si palë në procedurën administrative dhe oferta e saj është refuzuar/skualifikuar nga AK. Për pasojë, legjitimohet plotësisht për të kundërshtuar vendimin e AK që i ka cenuar interesat dhe të drejtat e ligjshme gjatë procedurës administrative. Pra, edhe ky kusht formal plotësohet nga Kreatx SHPK.

Së fundi: Për formalitetet e tjera administrative, siç është edhe tarifa e ankimit administrativ, që e lejon apelimin pranë KSHA dhe KPP, rezulton që të jetë shlyer nga Kreatx SHPK, duke u provuar me mandatin bankar bashkëlidhur ankimit administrativ. Pra, edhe ky formalitet i ankimit administrativ është plotësuar nga Kreatx SHPK dhe për pasojë organet publike në instancat e apelimit duhet të shqyrtojnë ankimin administrativ.

4.2 Arsyeimi i ankimit administrativ të Kreatx SHPK.

Së pari: Vendimi për refuzimin e ofertës së Kreatx SHPK është i paligjshëm, pasi bie në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit të përcaktuar në nenet 12 dhe 109 të KPA dhe nenin 2 të LPP. Si i tillë, vendimi duhet të anulohet nga KSHA ose KPP.

Shkelja e parimit të proporcionalitetit për shkak se AK nuk ka zbatuar parashikimet ligjore. Ndonëse Kreatx SHPK ka depozituar që të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DST dhe oferta e paraqitur nga ana jonë është me çmimin më të ulët mes gjithë ofertuesve në tender, ajo është refuzuar dhe është skualifikuar nga AK. Ky veprim i AK është i paligjshëm sepse bie ndesh me parimin e proporcionalitetit të parashikuar në nenet 12 dhe 109 të KPA. Neni 12 i KPA përcakton se, 1. Çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale, ose mund të cenojë interesa legjitimë, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit. 2. Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është: a) i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitimë të palës; b) i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; dhe c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë. , ndërsa neni 109 i KPA përcakton se, Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit. .

Sipas dispozitave të KPA dhe të LPP, për vlerësimin e ofertave ekonomike gjatë procedurës së prokurimit publik, AK duhet të tregohet proporcional. Në rastin objekt ankimi administrativ, duke shpallur fitues të prokurimit publik OE Prisma SHPK me ofertën më të lartë ekonomike në çmimin prej 10 100 000 Lekë pa TVSH, edhe pse oferta e Kreatx SHPK ka çmimin më të ulët 8 235 000 Lekë pa TVSH, AK ka keqmenaxhuar fondet buxhetore, duke shkelur parimin e proporcionalitetit. Kështu, AK ka shkelur kriteret e parimit të proporcionalitetit sepse:

1.Ka cenuar interesin publik, duke mosmenaxhuar si duhet fondet buxhetore me shpalljen fitues të OE me ofertën me çmimin më të lartë. Diferenca mes çmimit më të ulët dhe çmimit fitues është përafërsisht 1 800 000 Lekë pa TVSH. Kjo diferencë tregon qartë cenimin e proporcionalitetit për shkak të shpenzimit të lartë financiar në buxhetin e shtetit.

2.Shpallja fitues e OE ofertues me çmimin më të lartë nuk ka qenë i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj, për sa kohë që ka pasur një ofertë me çmimin më të ulët.

3.Realizimi i shërbimeve mund të ishte kryer me kosto më të ulët për buxhetin e shtetit dhe duke mos cenuar në të njëjtën kohë të drejtat dhe interesat legjitimë të Kreatx SHPK.

4.Veprimet e AK nuk kanë qenë të përshtatshme për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj dhe nuk janë në përpjesëtim të drejtë me nevojën e prokurimit publik, pasi shërbimi i fiskalizimit në vend që të merrej me kosto më të ulët, që preferuar të merret me një çmim më të lartë.

Për këto arsye, KSHA dhe KPP duhet të anulojnë vendimin e KVO së UKT SHA për skualifikimin e ofertës së Kreatx SHPK, për shkak se është ndodhemi përpara një vendimi të paligjshëm, që bie ndesh me parimin e proporcionalitetit.

Shkelja e parimit të proporcionalitetit për shkak se AK nuk ka marrë në konsideratë praktikën e mëparshme administrative të saj dhe të shoqërisë tregtare Kreatx SHPK, nga ku rezulton se shërbimi i fiskalizimit dhe i mirëmbajtjes së faturimit për UKT SHA dhe për autoritete të tjera kontraktore që përdorin sistemin Al-Billing është ofruar më parë dhe vijon të ofrohet nga ana jonë. Një ndër arsyet që AK ka skualifikuar ofertën e Kreatx SHPK është mungesa e autorizimit nga prodhuesi/distributori i autorizuar (pika 2.5 e shtojcës nr.9 të DST) për sistemin e faturimit AL-

Billing, edhe pse Kreatx SHPK e ka plotësuar këtë kriter, duke ofertuar me një sistem faturimi ekuivalent si Flare-Billing. Ky vlerësim i AK bie ndesh me parimin e proporcionalitetit, pasi AK po skualifikon një OE ofertues në mënyrë joproporcionale, duke i kërkuar të plotësojë një kriter kualifikues për një sistem kompjuterik që nuk është objekt i prokurimit publik. Skualifikimi i ofertës së Kreatx në këtë rast bie ndesh me parimin e proporcionalitetit. Në të njëjtën kohë, AK ka vendosur që të ndërmarrë ndaj Kreatx SHPK masën administrative më ekstreme, duke skualifikuar ofertën e saj, pavarësisht nga fakti se ky OE ofertues ka realizuar dhe vijon të realizojë me sukses kontrata administrative për shërbimin e fiskalizimit, të mirëmbajtjes së faturimit dhe shërbime të tjera TIK, si me UKT SHA edhe AK të tjerë që përdorin sistemin e faturimit Al-Billing. Informojmë KSHA dhe KPP se, Kreatx SHPK ka ofruar dhe ofron shërbimin e fiskalizimit, të mirëmbajtjes faturimit dhe shërbime të tjera TIK të lidhura me to, për disa nga AK, duke përfshirë këtu edhe vetë UKT SHA si vijon:

- 1.Kontrata administrative nr.114/6 prot., datë 23.07.2024, me objekt Shërbimi fiskalizimi të faturave të shitjes , me vlerë 400 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Lushnjë SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është shoqëruar me vërtetimin e realizimit nr.1067/1 prot., datë 07.11.2025 nga AK. (Prova nr.8);
- 2.Kontrata administrative nr.159/7 prot., datë 19.05.2022, me objekt Fiskalizimi i faturave dhe veprimeve të arkave , me vlerë 480 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Korçë SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është shoqëruar me vërtetimin e realizimit nr.219/1 prot., datë 27.03.2023 nga AK. (Prova nr.9);
- 3.Kontrata administrative nr.1067/5 prot., datë 02.08.2023, me objekt Fiskalizim i faturave të shitjes , me vlerë 491 666.5 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Lushnjë SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është shoqëruar me vërtetimin e realizimit nr.1533/1 prot., datë 07.11.2024 nga AK. (Prova nr.10);
- 4.Kontrata administrative nr.1736 prot., datë 31.10.2022, me objekt Shërbimi i fiskalizimit , me vlerë 620 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Shkodër SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. (Prova nr.11);
- 5.Kontrata administrative nr.439/6 prot., datë 23.12.2022, me objekt Blerje shërbimi zhvillime dhe konfigurime për sistemin e fiskalizimit të faturave tatimore elektronike , me vlerë 340 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Korçë SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është shoqëruar me vërtetimin e realizimit nr.289/1 prot., datë 20.04.2023 nga AK. (Prova nr.12);
- 6.Kontrata administrative nr.355/40 prot., datë 18.05.2026, me objekt Shërbimi i fiskalizimit të faturave , me vlerë 1 864 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Korçë SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është duke u zbatuar nga AK aktualisht. (Prova nr.12);
- 7.Kontrata administrative nr.355/40 prot., datë 18.05.2026, me objekt Shërbimi i fiskalizimit të faturave , me vlerë 1 864 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Korçë SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është duke u zbatuar nga AK aktualisht. (Prova nr.13);

8.Kontrata administrative nr.12217/7 prot., datë 07.11.2025, me objekt Përmirësimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtjedhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve , me vlerë 118 880 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor UKT SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është duke u zbatuar nga AK aktualisht dhe Kreatx SHPK po kryen shërbimet e implementimit për një pjesë të Al-Billing siç dokumentohet edhe në marrëveshjen e bashkëpunimit të depozituar pranë UKT SHA nga BOE i përbërë prej Prisma SHPK, Kreatx SHPK dhe Jehona Soft SHPK (Provat nr.14 dhe 14/1).

9.Kontrata administrative nr.16613/16 prot., datë 14.05.2021, me objekt Mirëmbajtjes sistem billingu , me vlerë 5 880 000 Lekë me TVSH, me autoritet kontraktor UKT SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është konfirmuar me vërtetimin e realizimit nr.K-754/1 prot., datë 20.03.2023. (Prova nr.15).

Të gjitha kontratat administrative më lart tregojnë që Kreatx SHPK zotëron dhe disponon kapacitetet teknike dhe profesionale për të përmbushur detyrimet kontraktore sipas nevojave të UKT SHA, pasi e ka ofruar shërbimin e fiskalizimit edhe për institucionet që kanë të implementuar sistemin e faturimit Al-Billing. Për pasojë, vendimi i UKT SHA që ka skualifikuar ofertën ekonomike të Kreatx SHPK ka qenë totalisht jo proporcional.

Së dyti: Vendimi për refuzimin e ofertës së Kreatx SHPK është i paligjshëm/pavlefshëm, pasi për nxjerrjen e tij AK është bazuar në ligjin nr.9643/2006 Për prokurimin publik dhe VKM n.914/2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik . Këto akte juridike janë shfuqizuar tashmë nga ligji nr.162/2020 Për prokurimin publik , i ndryshuar dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik , e ndryshuar, e për pasojë të gjitha veprimet administrative të mbështetura nga AK në akte juridike të shfuqizuara janë të paligjshme/pavlefshme dhe duhet të anulohen nga KSHA dhe KPP.

Në fund të formularit të skualifikimit që AK i ka dërguar Kreatx SHPK (Prova nr.16 bashkëlidhur ankimit) rezulton të jetë shprehur në këtë mënyrë: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtim i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për Prokurimin publik , i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për Miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. .

Ky vlerësim i KVO pranë UKT SHA është bazuar në legjislacionin e shfuqizuar të prokurimit publik, që nuk aplikohet më tashmë nga AK, pasi në muajin mars të vitit 2021, tashmë gjen zbatimin një kuadër i ri legjislativ për prokurimin publik, i harmonizuar tashmë me rregullat evropiane të prokurimit publik. Aktualisht, si LPP shërben ligji nr.162/2020, i ndryshuar, ndërsa si RRPP shërben VKM nr.285, datë 19.05.2021, e ndryshuar.

Në kushtet kur KVO pranë AK e ka mbështetur vendimin e skualifikimit/shpalljes së pavlefshme të ofertës së Kreatx SHPK në kuadër legjislativ të shfuqizuar, atëherë ndodhemi përpara një akti administrativ të paligjshëm të nxjerrë nga ana e organit publik në zbatim të nenit 109 të KPA, që parashikon se: Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi; d) është në kundërshtim me ligjin

material; . Në rastin konkret objekt ankimi administrativ, KVO ka nxjerrë një akt të paligjshëm administrativ për skualifikimin e ofertës së Kreatx SHPK, që duhet të anulohet nga KSHA dhe KPP, pasi legjislaicioni që ka përdorur për të kryer vlerësimin është i shfuqizuar dhe inekzistent. Kjo ka sjellë si pasojë që, vendimi i KVO pranë AK të jetë i paligjshëm për shkak se është nxjerrë pa autorizim ligjor dhe në kundërshtim me ligjin material për prokurimin publik të zbatueshëm në fuqi.

Së treti: Vendimi për refuzimin e ofertës së Kreatx SHPK është i paligjshëm/pavlefshëm, pasi nuk garanton të gjitha elementët formalë që duhet të ketë një akt administrativ. Për pasojë, AK dhe KPP duhet t'a anulojnë atë si të paligjshëm. Vendimit të KVO pranë AK i mungon procesverbali shoqërues i organit kolegjal (KVO), ç'ka e bën aktin pa vlerë juridike. Atij i mungon arsyetimi, pasi formulari i njoftimit paraparak të fituesit nuk përmban shkaqet e skualifikimit të ofertës së Kreatx SHPK. Vendimi i KVO nuk përmban as mjetet e ankimit administrativ për të orientuar Kreatx SHPK në KSHA dhe KPP sipas përcaktimeve të KPA dhe LPP.

Mungesa e procesverbalit shoqërues të vendimit të organit kolegjal KVO;

Vendimi për refuzimin e ofertës së Kreatx SHPK i nxjerrë nga KVO pranë AK është i paligjshëm/pavlefshëm, pasi nuk garanton të gjitha elementët formalë që duhet të ketë një akt administrativ. Konkretisht, meqenëse KVO operon për vlerësimin e ofertave të OE si organ kolegjal, në zbatim të pikës 5, të nenit 98, të KPA, ai duhet të shoqërohet nga procesverbali i mbajtur nga organi kolegjal që dokumenton mbledhjen e KVO, datën dhe orën e mbledhjes, diskutimet, rendin e ditës, si dhe vendimmarrjen e organit kolegjal, së bashku me mënyrën e votimit dhe kuorumin venidmmarrës. Në kushtet kur vlerësimi i KVO që refuzon ofertën e Kreatx SHPK nuk shoqërohet nga procesverbali i organit kolegjal, ai nuk mund të prodhojë efekte juridike për palët pjesëmarrëse në procedurën administrative, sepse është i paligjshëm në kuptim të nenit 109, shkronja c, të KPA.

Mungesa e arsyetimit të formularit të njoftimit paraparak të fituesit, pasi nuk shënohen arsyet e skualifikimit të ofertës së Kreatx SHPK;

Në vijim të arsyetimit më lart, shkeljet formale në përmbajtjen e akteve administrative të AK nuk ndalen. Po të shohësh me vëmendje përmbajtjen e Formularit të Njoftimit Paraparak të Fituesit që AK ka publikuar në SPE, atij i mungon arsyetimi sepse nuk paraqet asnjë argumentim se përse oferta ekonomike e Kreatx SHPK skualifikohet. Mungesa e argumentave për skualifikimin e Kreatx SHPK nuk përputhet me standardet e një akti administrativ të arsyetuar siç e kërkon neni 99 i KPA dhe neni 32 i VKM nr.285/2021, të ndryshuar.

Sipas nenit 99, pika 2, shkronja b, të KPA, aktet e organeve publike duhet të përmbajnë pjesën arsyetuese, që në zbatim të nenit 100 të KPA përfshin:

- a) shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti;
- b) shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave;
- c) bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast;
- ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar.

Po kështu, në pikën 3, të nenit 32, të RRPP parashikohet se, 3. Njoftimi i fituesit për kontratën sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të përmbajë të paktën: - emrat, NIPT-et e ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit. . Në situatën që Formulari i Njoftimit Paraprak të Fituesit nuk përmban shkaqet e skualifikimit të ofertës së Kreatx SHPK dhe ato nuk janë publikuar në SPE, atëherë ndodhemi përpara një akti të paligjshëm që nuk respekton aspektet formale të tij.

Mungesa e mjeteve dhe afateve të ankimit në vendimin e KVO për skualifikimin e ofertës së Kreatx SHPK;

Në fund të formularit të skualifikimit, AK shprehet se: Nëse mendoni se autoriteti/enti kontraktor ka shkelur LPP-në ose RPP-në gjatë procedurës së prokurimit publik, ju keni të drejtë të inicioni një procedurë rishikimi pas publikimit të njoftimit të fituesit sipas parashikimeve të Kapitullin XIV të Ligjit të Prokurimit Publik. . Ky formulim dhe mënyrë të shprehuri bie ndesh me nenin 99 të KPA, që kërkon medoemos që organet publike të pasqyrojnë në aktet e tyre administrative afatet dhe mjetet e ankimit. Shiko përmbajtjen e nenit 99 të KPA si vijon: 2. Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik përmban: iii) të drejtën e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përllogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit. .

KVO pranë AK çmon se ndaj vendimit të saj gjen zbatim mjeti ligjor administrativ i rishikimit , por ky orientim është sa i pabazuar ashtu edhe joligjor, pasi sipas neneve 109 të LPP dhe 94 të RRPP, mjeti ligjor administrativ që gjen zbatim në këto rate është ankimi administrativ në KSHA dhe KPP. Në raport me këto mjete ligjore ankimore, KVO pranë AK duhet të kishte përcaktuar të drejtën e ankimit administrativ në KSHA dhe KPP brenda 7 ditëve, duke nisur ky afat nga e nesërmja e publikimit të njoftimit paraprak të fituesit. Për sa kohë që në aktet e KVO mungon ky aspekt formal, atëherë ndodhemi para një akti administrativ të paligjshëm, që duhet të anulohet nga KSHA dhe KPP.

Kështu, të gjitha të metat formale të aktit si më lart, e bëjnë vendimin e KVO për skualifikimin e ofertës së Kreatx SHPK të paligjshëm. Për rrjedhojë, ky akt duhet të anulohet nga KSHA pranë AK dhe KPP.

Së katërti: Vendimi i KVO për skualifikimin e ofertës së Kreatx SHPK është i paligjshëm, pasi arsyet e skualifikimit nuk janë të mbështetura në legjislacionin e prokurimit publik, KPA dhe në legjislacionin e zbatueshëm në fuqi. Për pasojë, vendimi i KVO duhet të anulohet nga KSHA dhe KPP.

Kreatx SHPK çmon se vlerësimi i KVO pranë UKT SHA nuk përmban shkaqe të ligjshme dhe arsye të ligjshme skualifikimi, e për pasojë ndodhemi para një akti administrativ të paligjshëm që duhet të anulohet nga KSHA pranë UKT SHA dhe nga KPP. Për të provuar këto pretendime, I marrim me radhë që të gjitha arsyet e skualifikimit si vijon.

Shkaku i parë i skualifikimit se, Kreatx SHPK nuk plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.5 të shtojcës nr.9 të DST, për autorizim nga prodhuesi për sistemin e faturimit Al-Billing dhe sistemin ETL/Dataintegartion.

Në pikën 2.5, të shtojcës nr.9 të DST AK ka përaktuar se: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për objektin e prokurimit me prodhuesin e sistemeve të specifikuar si mëposhte:?

Për Programin Kompjuterik të faturimit, të përdorur nga UKT i cili kërkohej të integrohet;?

Për Programin Kompjuterik ETL/DataIntegration, i cili do të ofertohej; Autorizimi i prodhuesit kërkohej të jete specifik për këtë procedurë prokurimi, duhet të drejtohet AK dhe të përmbajë referencat e procedurës. Dokumenti i autorizimit duhet të përmbajë kontraktin telefon, email apo tjetër të prodhuesit/distributorit të autorizuar në mënyrë që të mundësojë AK verifikimet e nevojshme.

Për të plotësuar këtë kriter kualifikues, Kreatx SHPK ka depozituar në SPE deklaratë për disponimin e sistemit ekuivalent të faturimit Flare-Billing, certifikatën e të drejtës së autorit për sistemin ekuivalent të faturimit Flare Billing, si dhe deklaratën se disponon sistemin ekuivalent ETL/Dataintegration. Këto dokumenta, edhe pse janë ekuivalentë dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në DST, nuk janë marrë në konsideratë nga KVO pranë AK.

Në lidhje me këtë kriter kualifikues KVO pranë UKT SHA çmon se, Gjatë verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se operatori ekonomik nuk e ka përmbushur kërkesën e përcaktuar në pikën 2.5 të Dokumenteve Standarde të Tenderit, si në aspektin formal ashtu edhe në atë substancial. Kriteri në fjalë nuk është formuluar në mënyrë të përgjithshme për paraqitjen e një zgjidhje faturimi apo të një sistemi ekuivalent, por lidhet drejtpërdrejt me programin ekzistues të faturimit në përdorim nga UKT, i cili përbën platformën bazë me të cilën duhet të integrohet zgjidhja e kërkuar në kuadër të kontratës. Për këtë arsye, autorizimi nga prodhuesi i këtij sistemi përbën një kërkesë thelbësore dhe të domosdoshme për kualifikimin e operatorit ekonomik. (...) Paraqitja e një sistemi tjetër nga operatori ekonomik dëshmon një keqinterpretim të kërkesës së DST-së, pasi objekti i procedurës nuk konsiston në zëvendësimin e sistemit ekzistues të faturimit të UKT-së, por në integrimin me të. Për rrjedhojë, oferta e paraqitur devijon nga kërkesa themelore e dokumenteve të tenderit dhe nuk i përgjigjet objektit të kontratës së prokuruar. Kjo mospërputhje nuk mund të konsiderohet si mangësi formale apo e korrigjueshme, por përbën një devijim material nga kërkesat e DST-së, duke cenuar parimin e përgjegjshmërisë së ofertës. Një ofertë konsiderohet e përgjegjshme vetëm kur përmbush plotësisht kërkesat e dokumenteve të tenderit, pa ndryshuar natyrën e objektit të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Vlerësimi i mësipërm i KVO pranë UKT SHA është në kundërshtim flagrant me LPP dhe RRPP për disa arsye që renditen si më poshtë:

1.Kreatx SHPK e ka plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.5 të shtojcës nr.9 të DST me sisteme ekuivalente faturimi dhe ETL/Dataintegration. Për këtë qëllim në dokumentacionin e ngarkuar në DST Kreatx SHPK ka depozituar:

- a.Deklaratën për disponimin e sistemit ekuivalent të faturimit Flare-Billing me AL-Billing;
- b. Certifikatën e të drejtës së autorit për sistemin ekuivalent të faturimit Flare Billing;
- c. Deklaratën për disponimin e sistemit ekuivalent ETL/Dataintegration.

Këto dokumenta, edhe pse janë ekuivalentë dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në DST, nuk janë marrë në konsideratë nga KVO pranë AK.

2.Disponimi nga Kreatx SHPK i pronësisë intelektuale për sistemet ekuivalente të faturimit si Flare/Billing dhe të ETL/Dataintegration, bën që OE ofertues të përmbushë kriterin kualifikues në përputhje me LPP dhe RRPP. Kjo sjell si rezultat, skualifikimin e paligjshëm nga KVO të Kreatx SHPK.

3.Kriteri kualifikues në pikën 2.5 të shtojcës nr.9 të DST është formuluar në kundërshtim flagrant me LPP dhe RRPP. Në kushtet kur kriteri kualifikues nuk bazohet në legjislacionin e prokurimit publik, atëherë edhe vlerësimi i KVO mbi këto kritere nuk mund të jetë kurrësesi i ligjshëm dhe të shërbejë për të skualifikuar OE ofertues. Paligjshmëria e kriterit qëndron në faktin se:

a.Autorizimi nga prodhuesi kërkohet për të drejta autori specifike siç është sistemi i faturimit Al-Billing/ETL DataIntegartion dhe nuk është shoqëruar me termin ekuivalent nga pas. Sipas nenit 36 të LPP dhe nenit 41 të RRPP, kur AK kërkon një produkt marke konkrete/patentekonkrete/të drejte autori konkrete në DST, ai ka detyrimin që për efekt të respektimit të konkurrencës (nenit 2 të LPP), të shoqërojë kriterin kualifikues për produktin me termin ekuivalent nga pas. Për as kohë që kriteri kualifikues bie ndesh me LPP dhe skualifikimi mbështetet në një kriter të paligjshëm, atëherë vendimi i KVO është kryekëput i paligjshëm.

b.AK ka kërkuar autorizimin të dedikuar prodhuesi/distributori i autorizuar për procedurën e prokurimit, gjë që bie ndesh me rekomandimin nr.787 prot., datë 23.01.2026 të Agjencisë së Prokurimit Publik, Mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime . Sipas këtij të fundit, për autorizimet nga prodhuesi/distributori i autorizuar, AK nuk duhet të vendosë përcaktime kufizuese vetëm për llojin e procedurës së prokurimit që po zhvillohet, pasi kufizon në mënyrë të padrejtë konkurrencën.

c.Kriteri kualifikues si më lart nuk ka qenë i justifikuar dhe i argumentuar në raport me objektin e prokurimit publik, pasi objekti i prokurimit ka qenë shërbimi i fiskalizimit dhe jo ai i faturimit apo ETL/Datatintegration. Kështu, skualifikimi i Kreatx SHPK përbën një masë administrative joproporcionale në raport me objektin e prokurimit dhe të pajustificuar nga KVO.

4.Skualifikimi i Kreatx SHPK është bërë në kundërshtim LPP. KVO ka shkelur meritokracinë dhe konkurrencën në procedurat e prokurimit publik, pasi duke kërkuar autorizime nga prodhuesi/Distributori i autorizuar për sistemin e faturimit Al-Billing dhe ETL/Dataintegration të dedikuar për këtë procedurë prokurimi, praktikisht ka legjitimuar si subjekte tregtare që të marrin pjesë në tender vetëm dy prodhuesit e këtyre dy sistemeve kompjuterike. Kjo sjellje e AK është bërë shkak për shkeljen e kuadrit legjislativ të prokurimit publik dhe pse jo edhe atij me karakter penal, në drejtim të veprës penale të shkejes së barazisë në tendera dhe ankande publike të sanksionuar në Kodin Penal, të ndryshuar.

5.Skualifikimi i Kreatx SHPK duke interpretuar ngushtë kriterin e mësipërm kualifikues bie në kundërshtim flagrant me praktikën administrative të KPP. Praktika administrative e KPP kërkon detyrimisht që AK të vlerësojnë ofertat e OE duke u bazuar edhe në sisteme ekuivalente kompjuterike/faturimi. Konkretisht, në vendimin nr.439/2026 të KPP, urdhërohet përdorimi i detyrueshëm i termit ekuivalent, kur kërkohet autorizimi nga prodhuesi/distributori i autorizuar

për programe/sisteme kompjuterike. Në vendimin nr.439/2026, KPP urdhëroi SHRUK Korçë SHA, që përkrah autorizimit të prodhuesit/distributorit të autorizuar për sistemin e faturimit Al-Billing, të shtojë nga pas tij edhe termin ekuivalent. Për pasojë, edhe vlerësimi i ofertave nga KVO duhet të bëhet mbi bazën e sistemeve ekuivalente kompjuterike. Rezulton se praktika e KPP nuk është zbatuar nga KVO në rastin tonë objekt ankimi administrativ. Kujtojmë që nëse KVO do të merrte për bazë sistemin ekuivalent Flare-Billing dhe ETL/Dataintegration, sipas dokumentacionit të paraqitur nga Kreatx SHPK dhe siç urdhëron KPP në praktikën e saj administrative, Kreatx SHPK e përmbush me sukses kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.5 të shtojcës nr.9 të DST.

6. Skualifikimi i OE Kreatx SHPK nga KVO për kriterin kualifikues të vendosur në pikën 2.5 të shtojcës nr.9 të DST është i paligjshëm, në kushtet kur Kreatx SHPK i provon AK se ka ofruar shërbimin e fiskalizimit edhe për institucione që kanë të implementuar sistemin Al-Billing. Për të mosrënë në përsëritje shih më tepër provat me nr.9-15, që përkojnë me kontratat administrative të përfunduara me sukses me disa AK, duke përfshirë këtu edhe kontratën administrative që po zbatohet me UKT SHA nr.12217/7 prot., datë 07.11.2025.

Nisur nga sa argumentohet më lart, vendimi i KVO për skualifikimin e ofertës ekonomike të Kreatx SHPK është i paligjshëm dhe duhet të anulohet nga KSHA dhe KPP.

Shkaku i dytë i skualifikimit se, Kreatx SHPK nuk plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.6 të shtojcës nr.9 të DST, për aftësitë/certifikimet për veprimtaritë dhe teknologjitë për sisteme Cloud në platformën që do të ofertohej.

Në pikën 2.6 të shtojcës nr.9 të DST AK ka përcaktuar kriterin kualifikues me këtë përmbajtje: 2.6 Operatorët ekonomikë duhet të zoteroje aftësitë/certifikimet për veprimtaritë dhe teknologjitë si mëposhte:- Për Fiskalizimin e Fatures. Zgjidhja softëare-ike e ofertuar duhet të jete e certifikuar për veprimtarinë e fiskalizimit, si mëposhte: Me?dhe pa para në dorë; Pa para në dorë, e-invoice; Faturë shoqëruese; - Për Sisteme Cloud, në platformën e cila do të ofertohej. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga Drejtoria e Tatimeve dhe AKSHI, prodhuesit e programeve dhe teknologjive që po ofertojnë, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara nga prodhuesit për dhënien e tyre.

Për të përmbushur këtë kriter kualifikues, Kreatx SHPK ka ngarkuar në SPE deklaratë për zgjidhjen softëareike të fiskalizimit dhe platformën cloud ku ajo hostohet, deklaratë se disponon markën Oxana të regjistruar pranë DPPI si zgjidhje softëareike të fiskalizimit, certifikatën e regjistrimit të markës Oxana versioni 3.0, si dhe certifikatën e regjistrimit të zgjidhjes softëareike të fiskalizimit pranë AKSHI dhe DPT Oxana versioni 3.0.

Mes këtyre dokumentave, në deklaratën për zgjidhjen softëareike të fiskalizimit dhe të platformës OVH Cloud ku hostohet kjo zgjidhje softëareike fiskalizimi Kreatx SHPK deklaronte shprehimisht se:Në lidhje me platformën cloud rezulton se, shërbimi fiskalizimit përmes zgjidhjes softëareike Oxana hostohet në platformën e njohur OVH Cloud. Kjo platformë për shkak të politikës tregtare të OVH Cloud nuk ofron certifikatë për cloudin në raport me partnerët e saj tregtarë, siç rezulton që të jetë shoqëria tregtare Kreatx SHPK. Në këto kushte, shoqëria tregtare Kreatx SHPK, me NUIS me nr. L12121023B, me administrator z. Enor Nakuçi, deklaronte se jemi partnerë zyrtarë të OVH Cloud, i cili i përmbush të gjitha kërkesat e sigurisë dhe sipas DST. Kjo gjë vërtetohet me

pamjet e mëposhtme (...) Serverat e OVH Cloud janë të sigurtë në drejtim të mbrojtjes së të dhënave dhe sigurisë kibernetike dhe janë të pajisur me ISO 27001. Zona gjeografike ku shtrihet OVH Cloud është në Gjermani, Zvicër, Itali, Portugali, Austri, Belgjikë, Poloni dhe Danimarkë, etj. Parametrat e serverave në cloud janë publikë, e mund të verifikohen lehtësisht në https://partner.ovhcloud.com/en/partner/kreatx/?_gl=1*vivs3h*_gcl_au*MTY4OTQzMTQzOS4xNzY1OTg1ODAA1 Linku është aksesuar më datë: 20.05.2026, ora 12:48. Sjellim në vëmendje të UKT SHA se, në kushtet kur certifikata për partneritetin me OVH Cloud është e pamundur për t'u administruar dhe siguruar nga partneri zyrtar Kreatx SHPK, për shkak se nuk ekziston një e tillë, në zbatim të pikës 3, të nenit 80, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, informacioni i dhënë në faqen zyrtare të OVH Cloud [për partneritetin me Kreatx SHPK, përbën fakt të njohur botërisht dhe nuk ka nevojë që të provohet më tej me prova të tjera apo certifikata të ndryshme. Infrastruktura në cloud e OVH Cloud është publike dhe duke qenë e publikuar në faqen e zyrtare të saj, përbën fakt të njohur botërisht.

Lidhur me sa ka parashtruar Kreatx SHPK më lart, KVO pranë UKT SHA nuk i ka marrë në konsideratë provat e mësipërme, me argumentin e mëposhtëm: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se operatori ekonomik Kreatx nuk ka provuar përmbushjen e kriterit 2.6 të Dokumenteve Standarde të Tenderit. Kriteri 2.6 përbën një kriter kualifikimi me karakter formal dhe detyrues, i përcaktuar në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë, sipas të cilit kërkohet paraqitja e certifikimeve të lëshuara nga prodhuesit e programeve dhe teknologjive që do të ofrohen, ose nga autoritete të autorizuar prej tyre, për sistemet Cloud dhe platformën teknologjike që do të përdoret për realizimin e kontratës. Ky kriter është vendosur nga Autoriteti Kontraktor për të garantuar që infrastruktura Cloud, shërbimet e hostimit dhe operimi i sistemit të realizohen në mënyrë të autorizuar, të certifikuar dhe në përputhje me standardet teknike dhe ligjore të kërkuara. Rëndësia e tij është argumentuar edhe në dokumentacionin e miratimit të kriterëve të kualifikimit, duke qenë se objekti i kontratës lidhet drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve Cloud ku do të përpunohen, transmetohen dhe ruhen të dhëna operative, konfidenciale dhe të dhëna personale. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se operatori ekonomik nuk ka depozituar certifikimet e kërkuara në DST, por ka paraqitur vetëm një deklaram të vetin, të shoqëruar me referenca në faqe interneti, duke pretenduar se prodhuesi apo ofruesi i platformës nuk aplikon politika certifikimi për partnerët ose përdoruesit e shërbimit. Komisioni vlerëson se një deklaram i tillë nuk përbën dokumentacion provues dhe nuk mund të konsiderohet i barasvlershëm me certifikimet e kërkuara shprehimisht nga Dokumentet e Tenderit. Kërkesa e DST-së është e qartë dhe kërkon paraqitjen e dokumenteve zyrtare të lëshuara nga prodhuesi ose nga autoritete të autorizuar prej tij. Për rrjedhojë, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik nuk përmbush formën dhe përmbajtjen e provës së kërkuar, duke rezultuar në mosplotësim të kriterit të kualifikimit. (...) Barra e provës për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit i takon ekskluzivisht operatorit ekonomik. Vlerësimi i mësipërm i KVO pranë UKT SHA është në kundërshtim flagrant me LPP, RRPP dhe KPA për arsytet që renditen si më poshtë:

1.Në ndryshim nga çfarë pretendon KVO, Kreatx SHPK i ka provuar kapacitetet e saj se shërbimi i fiskalizimit Oxana versioni 3.0 hostohet në OVH cloud. Ky cloud provider është tejet i njohur ndërkombëtarisht, pasi zotëron zyra përfaqësimi në të gjithë rruzullin tokësor, sipas një shpërndarje gjeografike në çdo kontinent, që është publike botërisht në faqen e tij zyrtare. Po kaq i njohur botërisht është edhe fakti se, ky partner nuk lëshon certifikime për OE që përdorin shërbimet e tij. Prandaj, politika e tij është publikimi i partnerëve në faqen zyrtare dhe çdokush mund të njihet me këtë informacion publik vetëm me një klikim.

2.Kreatx SHPK i ka demonstruar AK dhe KVO me prova konkrete siç është deklarata me shkrim se, është partner zyrtar dhe i avancuar i OVH Cloud dhe kjo gjë verifikohet lehtësisht në faqen zyrtare të OVH Cloud, respektivisht në linkun: https://partner.ovhcloud.com/en/partner/kreatx/?_gl=1*vivs3h*_gcl_au*MTY4OTQzMTQzOS4xNzY1OTg1ODA1

3.Kreatx SHPK ka përmbushur barrën e provës në kuptim të nenit 80, pika 3, të KPA, për sa kohë që i gjithë informacioni, dokumentacioni dhe shërbimet që marrim në OVH cloud janë publike. Kështu, neni 80, pika 3, i KPA, përcakton se, Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme. Në kushtet kur të gjitha faqet zyrtare të subjekteve tregtare gjenden lehtësisht në internet dhe ato përbëjnë fakte të njohura botërisht, pa pasur nevojë për të paraqitur dokumentacion apo certifikime shtesë për AK. Kështu, Kreatx SHPK e ka përmbushur me sukses barrën e provës se, cloudi me të cilin operon OE është jo vetëm i certifikuar dhe i sigurtë, por kënaq edhe kërkesatapo nevojat e AK për prokurimin publik, duke e informuar KVO për sigurinë e të dhënave, për mbrojtjen e të dhënave që ofron OVH Cloud, parametrat e serverave në cloud, vendndodhjen e tyre, etj. Gjithashtu, informacioni i dhënë nga Kreatx SHPK provon njëherazi se, OVH Cloud operon dhe në vendet e BE dhe është certifikuar si cloud provider për servera publike dhe privatë njëkohësisht me një standard të lartë shërbimi.

4.Skualifikimi i Kreatx SHPK për këtë kriter kualifikues nga KVO është gjithashtu joproporcional dhe në kundërshtim me nenin 12 të KPA. Duke kërkuar certifikime të panevojshme për OVH Cloud, ndonëse ky i fundit nuk lëshon deklarata apo certifikata për partnerët e tij, AK dhe KVO e kanë vendosur Kreatx SHPK në një situatë të pazakontë dhe i kanë ngarkuar OE ofertues një barrë joproporcionale në procedurën administrative. Për më tepër, karakteri joproporcional i barrës dallohet edhe nga fakti se, KVO nuk ka kërkuar as kërkesë për sqarim gjatë vlerësimit të ofertës së Kreatx SHPK, por ka vjuar direkt me skualifikimin e ofertës së tij. Kjo situatë shton edhe më tej, paligjshmërinë e veprimeve të AK dhe KVO.

5.Skualifikimi i Kreatx SHPK nga KVO pranë UKT SHA është bazuar mbi një kriter kualifikues të paqartë dhe të hartuar në kundërshtim me LPP dhe RRPP, pasi edhe në procesverbalin argumentues të DST lloji i certifikimit të kërkuar është i paidentifikueshëm. Në këtë drejtim, edhe sikur të paraqitej certifikatë, OE nuk e kanë pasur informacionin se çfarë certifikate duhet të vendosnin në dispozicion të AK për të përmbushur kriterin kualifikues. Vlen të theksojmë se, me interes për ankimin administrativ do të ishte edhe verifikimi nga KPP për mënyrën sesi e ka plotësuar OE fitues i prokurimit këtë kriter kualifikues. Pra, me çfarë lloj certifikate?

6. Skualifikimi i Kreatx SHPK nga KVO për këtë kriter kualifikues bie ndesh me parimin e transparencës dhe me praktikën administrative të prokurimit publik. Nisur nga fakti se shërbimet në cloud blihen/kontraktohen në shumicën e rasteve online, duke pranuar kriteret e shërbimeve të cloud providers, praktika administrative e prokurimit publik në këto raste, ka qenë paraqitja e deklaratave me shkrim, ku të jepen të dhënat dhe linket e cloud provoders, e ku të verifikohen kërkesat e tij lidhur me standardet ligjore dhe parametrat teknikë. Në praktikën administrative të dhënat janë verifikuar gjithnjë në faqet zyrtare të cloud providers, pa nevojën për të depozituar certifikata partneriteti apo kontrata me shkrim. Kjo praktikë është më transparente, siguron konkurrencën dhe është më e vlefshme për AK për efekt të verifikimeve që mund të kryhen nga AK. Duke mos ndjekur praktikën e shëndoshë administrative sipas këtij paragrafi, vendimi i KVO për skualifikimin e ofertës së Kreatx SHPK është rezultat i ushtrimit të paligjshëm të diskrecionit nga ana e organit publik, ndesh me sa parashikon neni 11 i KPA.

Nga sa argumentohet më lart, vendimi i KVO për skualifikimin e ofertës ekonomike të Kreatx SHPK është i paligjshëm dhe duhet të anulohet nga KSHA dhe KPP.

Shkaku i tretë i skualifikimit se, Kreatx SHPK nuk plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në shkronjën d , të pikës 2.7 të shtojcës nr.9 të DST, për punonjësit e certifikuar.

Në shkronjën d , pika 2.7, të shtojcës nr.9, të DST së publikuar nga AK, si kriter kualifikues është vendosur: Kërkesa 2.7. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, prej të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të angazhohet në realizimin e shërbimeve objekt kontrate, si më poshtë: d) 1 (nje) punonjës të çertifikuar për sisteme BI, per platformën që do të përdoret, përcaktuar në terma të references (Oracle Analytics ose equivalent).

Për të përmbushur këtë kriter kualifikues, Kreatx SHPK ka ngarkuar në SPE certifikatat për dy punonjësit e mëposhtëm:

1. Microsoft Transcript - Microsoft Certified Solution Associate BI Reporting për Z. E.N.;
2. Certifikatën Bussines Intelligence Professional nga VsKills për Z. M.S.;
3. Certifikatën Ekspert i certifikuar për Oxana BI ? Z. M.S.
4. Certifikatën Ekspert i certifikuar për Oxana AI Floëgram ? Z. M.S.

Të gjitha certifikatat e mësipërme janë certifikata të dedikuara për sisteme BI ekuivalente me atë që kërkon AK - UKT SHA.

Pavarësisht sa më lart, AK nuk i ka pranuar si të vlefshme apo ekuivalente këto certifikime ndonëse ato të tilla janë. KVO argumenton se: Komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon se thelbi i këtij kriteri nuk është vetëm që operatori të disponojë staf me njohuri të përgjithshme në IT, por që të provojë se ky staf është i certifikuar në mënyrë specifike, të drejtpërdrejtë dhe në përputhje me teknologjitë dhe sistemet konkrete të kërkuara nga DST, duke garantuar realizimin e kontratës pa rrezik teknik apo funksional. (...) Në përgjigje të kësaj kërkesë për personel të Certifikuar në platforme BI (referuar formularit të vete deklarimit) paraqiten: - transcript te Microsoft per Microsoft Certified Solution Associate BI Reporting (të cilat datojnë kohë më parë) por jo nje certifikate në Mircosoft per platforma BI, si dhe - certifikata Business Intelligence (BI) të përgjitheshme (pa një teknologji apo produkt Oracle Analytics apo një produkt equivalent) te

leshuara nga VsSkills; apo - Certifikata në OXANA BI; në Oxana AI Floëgram; në Oxana DataSource Builder; në Oxana Report Builder (pa një teknologji apo product Oracle Analytics apo një produkt equivalent) të lëshuara nga vete OE. Në mënyre të vecantë, OE në përgjigje të kësaj kërkesë nuk paraqet argumenta që produkti Oxana, mundet të jete equivalent me platformën ekzistuese Oracle Analytics. .

Vlerësimi i mësipërm i KVO pranë UKT SHA është në kundërshtim flagrant me LPP dhe RRPP për arsye që renditen si më poshtë:

1.Kreatx SHPK ka plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar nga AK, duke depozituar katër certifikime ekuivalente për BI, siç shpjegohet më lart, në ndryshim nga sa pretendon AK. Në këtë mënyrë, Kreatx SHPK e ka tejkaluar kriterin kualifikues të vendosur nga AK me një punonjës të certifikuar në BI. Kjo është dukshme, pasi edhe vetë AK e pranon një gjë të tillë. Pra, në drejtim të dokumentacionit provues rezulton se, Kreatx SHPK e ka plotësuar atë dhe nuk ka hapësirë për diskutime dhe skualifikimi i KVO për këtë shkak është i pabazuar në ligj.

2.Në ndryshim nga sa vlerëson AK, certifikimet e paraqitura nga AK për kriteri kualifikues nuk janë certifikime IT të përgjithshme, por të posaçme, pasi i dedikohen shërbimeve BI dhe janë ekuivalente me atë që kërkon AK. Pra, vlerësimi i AK edhe në këtë drejtim është i pabazuar në ligj;

3.Certifikata Microsoft Transcript - Microsoft Certified Solution Associate BI Reporting e punonjësit E.N. ndryshe nga sa pretendon AK, nuk është e skaduar, por ende e vlefshme dhe mund të konfirmohet edhe në platformën Microsoft me datën e lëshimit dhe vlefshmërinë e saj. Po kështu, pretendimi i KVO pranë UKT SHA se, certifikimi nuk është ekuivalent me atë që ka nevojë AK, bie poshtë, pasi KVO nuk ka dhënë argumenta mbi mungesën e ekuivalencës së tyre. Është detyrë e AK dhe KVO që të japin argumenta për mungesën e ekuivalencës mes certifikimeve. Për më tepër, në kushtet kur AK ka përcaktuar qartë se kriteri kualifikues mund të plotësohet edhe me certifikime ekuivalente, KVO ka pasur detyrimin që minimalisht të kërkonte sqarime nga Kreatx SHPK për të kuptuar ose jo ekuivalencën e certifikimeve të depozituara nga ana jonë.

Kësisoj, marrja e vendimit të skualifikimit pa kërkuar sqarime sipas LPP dhe RRPP, e bën vendimin e KVO të paligjshëm dhe joproporcional, si në raport me nenin 12 të KPA, ashtu edhe në raport me nenet 92 e në vijim të LPP dhe nenet 82 e në vijim të RRPP. Duke bërë një vlerësim të paarsyetuar dhe lakonik, që nuk shpjegon se përse certifikimet tona s'janë ekuivalente me Oracle Analytics, vendimi i KVO për skualifikimin e ofertës së Kreatx SHPK është i pabazuar si në fakte e prova, ashtu edhe në ligj. Prandaj, vendimi i KVO mbetet i paligjshëm.

4.Po ashtu, subjektiv dhe i pabazuar në ligj është edhe pretendimi i AK se sistemi që përdor UKT SHA Oracle Analytics OCI nuk mund të konsiderohet ekuivalent me sistemin Oxana, pasi të gjitha shërbimet e kërkuara nga AK në specifikime teknike dhe termat e referencës Oxana i përmbush me sukses. Për të dokumentuar këtë pretendim tonin, UKT SHA i janë vendosur në dispozicion edhe katalogët për Oxana dhe Oxana ETL Dataintegration, ku evidentohet qartë se, të gjitha shërbimet për të cilat ka nevojë për prokurim UKT SHA, Kreatx SHPK ka mundësinë që t'i ofrojë me sistemet Oxana dhe Oxana ETL/Dataintegration. Pra, vendimi i KVO për skualifikimin e

ofertës së Kreatx SHPK është i pambështetur në prova dhe fakte dhe duhet të shfuqizohet nga KSHA dhe KPP.

5.AK dhe KVO nuk i kanë dhënë mundësinë Kreatx SHPK që të sqarojë ekuivalencën mes sistemeve Oracle dhe Oxana, si dhe ekuivalencën e certiikimeve BI me atë të kërkuar nga UKT SHA, pasi KVO nuk ka kërkuar sqarime nga Kreatx SHPK, duke i mohur mundësinë e pjesëmarrjes në procedurën administrative në përputhje me parimet e LPP dhe të KPA.

Për sa shpjegohet më lart, vendimi i KVO për skualifikimin e ofertës së Kreatx SHPK është i paligjshëm dhe duhet të anulohet nga KSHA dhe KPP.

Shkaku i katërt i skualifikimit se, Kreatx SHPK nuk plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në shkronjën pikën 2.8 të shtojcës nr.9 të DST, për depozitimin e katalogëve të produkteve që po ofertohej dhe po prokuron UKT SHA.

Në pikën 2.8 të shtojcës nr.9 të DST, AK ka përcaktuar kriterin kualifikues me këtë përmbajtje: 2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, lidhur me produktet softëare/komjuterike te gatshem duhet të paraqesë materiale/kataloge/datasheet teknike të prodhuesve. Katalogjet teknike kerkohen per produktet standarde te ofruara, minimalisht per sistemin e fiskalizimit, si dhe ETL/DataIntegration te ofertuar; Për të përmbushur kriterin e mësipërm kualifikues, Kreatx SHPK ka depozituar dy dokumentat e mëposhtëm:

1. Katalogun e produktit Oxana ETL/Dataintegration & BI, 9 fletë;

2. Katalogun e produktit Oxana.

Në këtë mënyrë, për të dyja produktet e gatshme të fiskalizimit dhe ETL/Dataintegraion, Kreatx SHPK e ka përmbushur kriterin kualifikues sipas pikës 2.8 të shtojcës nr.9 të DST.

Pavarësisht sa më lart, KVO pranë AK nuk ka marrë në konsideratë dokumentacionin e depozituar nga Kreatx SHPK me argumentimin si vijon: Materialet e paraqituranga OE ofertues nuk përmbushin në mënyrë substanciale kërkesën e DST për katalogje teknike të prodhuesit, për arsyet si më poshtë: Së pari: Dokumentet e paraqitura nuk rezultojnë të jenë katalogë teknikë të standardizuar apo datasheet të prodhuesit, të cilat zakonisht përmbajnë specifika të verifikueshme teknike, parametra funksionalë, versione, arkitekturë të standardizuar, kërkesa infrastrukture dhe dokumentim teknik të strukturuar. Në vend të kësaj, dokumentet janë të përpiluara në formë përshkrimi narrativ dhe tabelor për nevoja të procedurës konkrete të tenderit, duke deklaruar shprehimisht se shërbejnë si material produkti për dokumentacionin teknik të tenderit . Duke konfirmuar që nuk kemi të bëjme me nje produkt standard, por me nje material apo zgjidhje të përgatitur posaçërisht për këtë procedurë. Së dyti, në lidhje me komponentin më kritik, ETL/DataIntegration, rezulton një problem edhe më thelbësor. Dokumenti i paraqitur për Oxana ETL/Data Integration & BI është një material i hartuar për këtë tender, i cili:

- deklaron vetë qëllimin si evidentimi i përputhshmërisë me kërkesat e tenderit

- përshkruan zgjidhjen në kontekstin specifik të UKT dhe integritimit me sistemet e saj (, Oracle DËH, OAC); ? paraqet një matricë përputhshmërie ku vetë produkti vlerëson përmbushjen e kërkesave të tenderit. Ky lloj dokumenti nuk përbën një datasheet teknik të një produkti standard në treg, por një material të personalizuar për këtë procedurë, i cili nuk garanton karakterin e një produkti të gatshëm dhe të verifikueshëm në mënyrë të pavarur. Më tej, nga përmbajtja e

dokumentit rezulton se komponenti ETL paraqitet si një kombinim i moduleve të zhvilluara nga vetë operatori (Floëgram, Data Source Builder, Report Builder, BI), të cilat përputhen edhe me analizën e mëparshme mbi certifikimet dhe autorizimet, ku konstatohet se kemi të bëjmë me një zgjidhje të brendshme të operatorit dhe jo me një produkt të standardizuar nga një prodhues i njohur. Kjo përforcon faktin që katalogu i paraqitur nuk është dokument teknik i një produkti të standardizuar në kuptimin e DST.

Vlerësimi i mësipërm i KVO bie ndesh me LPP, RRPP, KPA dhe vetë dokumentacionin provues për shkaqet dhe arsyet e mëposhtme:

1.Ndryshe nga sa pretendon KVO, dy dokumentat e paraqitura nga Kreatx SHPK janë plotësisht katalogë teknikë të standardizuar me datasheete të prodhuesit, që përmbajnë specifikime të verifikueshme teknike, parametra funksionale, versione, arkitekturë të standardizuar, kërkesa infrastrukturore dhe dokumentim teknik të strukturuar siç e kërkon UKT SHA në specifikimet teknike të publikuara në shtojcën nr.6 të DST dhe termat e referencës të përcaktuara në shtojcën nr.8 të DST. Për rrjedhojë, ky vlerësim i KVO është arbitrar sepse vetë katalogët e dokumentojnë një gjë të tillë dhe po ashtu shërbejnë si provë në këtë drejtim.

2.Katalogët e paraqitur nga Kreatx SHPK përmbushin plotësisht kriterin kualifikues sipas DST, pasi janë produkte standarde që Kreatx SHPK i ofron në treg për klientët e saj prej vitesh.

Këto katalogë janë të vlefshëm që nga momenti i regjistrimit të zgjidhjes softëareike Oxana si markë në vitin 2020 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale. Për pasojë, vlerësimi KVO se nuk janë katalogë standardë të produkteve të ofruara në treg bie poshtë dhe është i pabazuar.

3.Fakti se në katalogët e depozituar pranë UKT SHA shënohet se, ato shërbejnë si material për këtë tender, nuk ndikon në vlerën dhe standardin e tyre, pasi përkundrazi ky shënim tregon seriozitetin e lartë dhe përkushtimin e Kreatx SHPK për të realizuar me sukses shërbimin e fiskalizimit sipas nevojave të UKT SHA. Në këtë drejtim, vlen të silllet në vëmendje të KSHA dhe KPP se, kriteri kualifikues nuk përmbante ndonjë pikë përbrenda tij se, nëse katalogët shoqërohen me shënimin se janë materiale për këtë procedurë prokurimi, OE ofertues do të skualifikohet nga KVO. Për rrjedhojë, skualifikimi i OE ofertues me argumentin se katalogët e produkteve standarde kanë shënimin materiale për këtë prokurim, përbën skualifikim të paarsyeshëm dhe joligjor. Madje skualifikimi në këtë rast është qesharak dhe i pambështet në LPP, RRPP dhe KPA, për sa kohë që Kreatx SHPK e ka plotësuar kriterin kualifikues me dokumentacionin provues siç e kërkon UKT SHA. Duket qartë se qëllimi i AK ka qenë të skualifikojë medoemos në mënyrë arbitrare OE ofertues Kreatx SHPK.

4.KVO gabon në vlerësim kur çmon se, produktet e mësipërme nuk janë produkte standarde dhe të njohura në treg, pasi Oxana qarkullon në treg që prej të paktën 6 vitesh dhe atë e përdorin si produkt më tepër se 330 subjekte tregtare në treg. Kjo mund të verifikohet edhe nga informacionet që mund të merren nga platforma e administratës tatimore qendrore, që konfirmon se produktet e evidentuara me katalogë nga Kreatx SHPK ofrohen si shërbime në treg prej vitesh.

5.Së fundi, sjellim në vëmendje të KPP se, produktet e kataloguara janë produkte standarde në treg dhe katalogët e tyre janë dokumente standarde të prodhuesit Kreatx SHPK dhe për pasojë ato

janë lehtësisht të verifikueshme pranë Kreatx SHPK. Theosjmë se, dokumentacioni më i saktë që mundëson verifikimin e kërkesave teknike të produkteve janë pikërisht katalogët e depozituara në SPE nga Kreatx SHPK. Pra, vendimi i KVO për skualifikimin e ofertës së Kreatx SHPK, duhet të anulohet nga KSHA dhe KPP si i pabazuar në prova, fakte dhe ligj.

6.Së fundi, sa i takon vlerësimin të KVO se, produktet e kataloguara nuk janë të pavarura nga operatori ekonomik dhe ndaj oferta e Kreatx SHPK duhet të skualifikohet, sjellim në vëmendje të AK se, skualifikimi me këtë argumentim është sa joligjor ashtu edhe i papërcaktuar në DST. Në DST, nuk përcaktohet shprehimisht se, OE ofertues nuk duhet të ofertonin me produktet e tyre teknologjike. Përkundrazi një ofertim me produkte nga prodhuesi nuk ndalohet. Për më tepër që sipas neneve 36 të LPP dhe 41 të RRPP, OE mund të ofertojnë me produkte ekuivalente të prodhura prej tyre, duke siguruar kështu meritokracinë në prokurimet publike. Duke skualifikuar Kreatx SHPK me një kriter të shpikur dhe të pashënuar në DST, AK ka shkelur LPP, KPA dhe parimet e ligjshmërisë dhe të sigurisë juridike. Parimi i sigurisë juridike në këtë rast shkelet pasi, kriteri kualifikues i parashikuar nga pika 2.8 e shtojcës nr.9 të DST nuk ka ndaluar OE ofertues që të paraqesin katalogë standardë të produkteve të tyre.

Në kushtet e mësipërme, vendimi i KVO për skualifikimin e ofertës së Kreatx SHPK është i pabazuar, i paligjshëm dhe si i tillë duhet anuluar nga KSHA dhe KPP.

Shkaku i fundit i skualifikimit se, oferta ekonomike e Kreatx SHPK ka mangësi në ofertën ekonomike.

Në shtojcën nr.2 të DST, UKT SHA ka përcaktuar listën e çmimeve për secilin artikull si vijon:

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	6		
Art.	Përshkrimi i shërbimit	Sasia	Njesia	Çmimi për njësi	Çmimi	total	për shërbime (3 x 4)

1. Hostimi si dhe sistemi i fiskalizimit, e-fatures dhe fatures se transportit per periudhen e kontrates. Perfshire

- nderfaqe API per fiskalizimin automatik nga sistemet e brendshme.

- Versioni ëeb, dhe mobile Apps. 1 Set

2. Hostim, zbatimi i modulit shkembimit ETL/Data Integration per sinkrinizimit e popullimin e te dhenave. Zhvillimi i raportimeve ne sistemi BI per procesin e fiskalizimit dhe integritimit. ??

1 Set

3. Sistemi i leshimi i faturave manuale ne zyrat dhe zonat e UKT (per minimum 80 Users);? 1 Modul

4. Sistemi i miratimit te faturave ne blerjen, ne nje ëorkfloë me minimalisht 3 hapa / aprovime. 1 Modul

5 Trajninin e perdoruesve te sistemit.

2 Klasa

6 Mirëmbajtja dhe support Sherbimi i suportit dhe mirembajtjes per ceshtje teknike dhe operacionale.

2 Vite

Rezulton se Kreatx SHPK në ofertën e saj ekonomike ka ofertuar për secilin prej zërave të shërbimeve të kërkuara nga UKT SHA me vlerat përkatëse për njësi dhe në total. Më tej, duke analizuar me kujdes DST dhe grafikun e ekzekutimit të publikuar në shtojcën nr.7 të DST dhe të modifikuar me shtojcën nr.2 për ndryshimin e DST, Kreatx SHPK ka ofertuar edhe për zërin e shërbimit Zhvillimi i raportimeve në sistemin Oracle Analytics Cloud për procesin e fiskalizimit dhe integritet me AI-Billing , ç`ka nuk ishte pasqyruar në listën e artikujve nga AK. Kuptohet, kjo ka ardhur si pasojë e faktit se, kur UKT SHA ka modifikuar në mënyrë të pjesshme DST, ka rregulluar pasaktësitë vetëm tek grafiku i ekzekutimit, duke harruar se në të njëjtën mënyrë si grafiku i ekzekutimit modifikimet vlenin edhe për listën e artikujve për efekt të unifikimit të shërbimeve të prokurara në DST.

Pavarësisht ofertimit të saktë nga Kreatx SHPK si më lart, sipas zërave të shërbimeve të kontratës administrative, abuziviteti i UKT arrin kulmin kur shprehet oferta ekonomike e Kreatx SHPK ka problematika, të cilat janë sajuar në momentin e vlerësimit nga KVO, pa qenë fare si zëra shërbimesh në DST. AK pretendon se: Gjatë verifikimit të dokumentacionit në SPE Komisioni I Vlerësimit të ofertave konstaton se në ofertën për shërbimin Sistemi ETL/Data Integrimi (Zëri 2: Hostim, zbatim i modulit ETL për sinkronizim dhe popullim të të dhënave), sipas DST vërehen këto mangësi: Nuk janë paraqitur katalogët standardë të produktit, sipas pikës 2.8 të kërkesave; Nuk specifikohet hostimi i Oxana ETL/Dataintegrator dhe mungon sqarimi për integrimin me platformat ekzistuese (OCI, Oracle EE 19c, Oracle Linux, OADB), si dhe respektimi i kërkesës që përpunimi të mos dalë jashtë tenantit Oracle OCI të UKT. Oferta teknike paraqitet si zgjidhje e personalizuar (konfigurim, ëorkfloë, integrim, raportim), ndërsa kjo kërkon një sistem të gatshëm, të certifikuar nga AKSHI ose DPT, pa ndryshime thelbësore në kodin bazë të platformës pra pa zhvillime shtesë për UKT. Në mungesë të katalogut të ETL/DataIntegrator, nuk mund të vlerësohen kërkesat bazë, veçanërisht për sigurinë (ambientet prod/test/dev, aksesin në të dhëna), integrimin me teknologjitë aktuale dhe vendndodhjen e sistemit, si edhe ndërveprimi me sisteme të jashtme. Vlerësimi i mësipërm i KVO është totalisht i paligjshëm sepse katalogët standardë të produktit nuk janë zë më vete shërbimi në ofertën ekonomike, me qëllim që të ofertonte Kreatx SHPK. Ato janë kritere kualifikuese sipas pikës 2.8 të shtojcës nr. 9 të DST. Pra, Kreatx SHPK nuk ka pasur detyrim që të shtojë zë në ofertë për katalogët e produkteve.

Vlerësimi më lart i KVO është i paligjshëm sepse hostimi i Oxana ETL/Dataintegrator dhe integrimi me platformat ekzistuese (OCI, Oracle EE 19c, Oracle Linux, OADB), bashke me respektimin e kërkesës së përpunimit jashtë tenantit Oracle OCI të UKT, nuk është zë pjesë e listës së artikujve/të çmimeve në ofertën ofertën ekonomike, me qëllim që Kreatx SHPK të ofertonte edhe për to.

Po ashtu, Kreatx SHPK nuk ka pasur detyrë sipas DST që të paraqesë ofertë teknike për zgjidhje të personalizuar softëareike. Në DST mungon një kriter kualifikues që detyron OE ofertues të paraqesin ofertën teknike. Pra, edhe kjo arsye skualifikimi nuk përputhet me LPP dhe RRPP dhe është abuzive nga KVO.

Në raport me vlerësimin e mësipërm të AK për ofertën ekonomike të Kreatx SHPK, skualifikimi i OE për zëra të paqenë në DST, e që nuk janë pjesë e ofertës ekonomike/listës së çmimeve të AK, përbën një veprim të rëndë dhe haptazi abuziv të KVO dhe e ngarkon organin kolegjal me përgjegjësi administrative, për të cilat OE do të vlerësojë referimin e çështjes tek organet kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

Për sa arsyetohet më lart, skualifikimi i ofertës së Kreatx SHPK bie ndesh me LPP, RRPP, si dhe KPA dhe ndaj vendimi i KVO pranë UKT SHA duhet të anulohet nga KSHA dhe KPP.

Për sa më lart, në zbatim të neneve 128 e në vijim të KPA, neneve 109 e në vijim, të LPP, si dhe neneve 94 e në vijim të RRPP, Kreatx SHPK kërkon:

1. Pranimin e plotë të ankimit administrativ të OE ofertues Kreatx SHPK.

2. Anulimin e vendimit të KVO pranë UKT SHA, për skualifikimin e ofertës ekonomike të OE Kreatx SHPK, si një akt administrativ i paligjshëm që shkel LPP, RRPP dhe KPA.

3. Detyrimin e KVO nga KSHA ose nga KPP që të procefojë me rivlerësimin e procedurës në fjalë të prokurimit, me qëllim shpalljen e Kreatx SHPK fitues të prokurimit si OE ofertues me çmimin më të ulët.

4. Kthimin e tarifës së ankimit administrativ nga KPP në llogaritë e OE ankimues Kreatx SHPK.

5. Njoftimin e vendimeve të KSHA dhe KPP OE ankimues Kreatx SHPK.

Dokumentacioni shoqëruar:

Prova nr.1 ? Kërkesa nr.1 për sqarim e Kreatx SHPK;

Prova nr.2 - Përgjigja nr.1 e UKT SHA për kërkesën për sqarim;

Prova nr.3 - Kërkesa nr.2 për sqarim e Kreatx SHPK;

Prova nr.4 - Përgjigja nr.2 e UKT SHA për kërkesën për sqarim;

Prova nr.5 - Kërkesa nr.3 për sqarim e Kreatx SHPK;

Prova nr.6 - Përgjigja nr.3 e UKT SHA për kërkesën për sqarim;

Prova nr.7 ? Formulari i Njoftimit Paraprakt të Fituesit;

Prova nr.8 - Kontrata administrative nr.114/6 prot., datë 23.07.2024, me objekt Shërbimi fiskalizimi të faturave të shitjes , me vlerë 400 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Lushnjë SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është shoqëruar me vërtetimin e realizimit nr.1067/1 prot., datë 07.11.2025 nga AK;

Prova nr.9 - Kontrata administrative nr.159/7 prot., datë 19.05.2022, me objekt Fiskalizimi i faturave dhe veprimeve të arkave , me vlerë 480 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Korçë SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është shoqëruar me vërtetimin e realizimit nr.219/1 prot., datë 27.03.2023 nga AK.;

Prova nr.10 - Kontrata administrative nr.1067/5 prot., datë 02.08.2023, me objekt Fiskalizim i faturave të shitjes , me vlerë 491 666.5 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Lushnjë SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është shoqëruar me vërtetimin e realizimit nr.1533/1 prot., datë 07.11.2024 nga AK.

Prova nr.11 - Kontrata administrative nr.1736 prot., datë 31.10.2022, me objekt Shërbimi i fiskalizimit , me vlerë 620 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Shkodër SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing.

Prova nr.12 - Kontrata administrative nr.439/6 prot., datë 23.12.2022, me objekt Blerje shërbimi zhvillime dhe konfigurime për sistemin e fiskalizimit të faturave tatimore elektronike, me vlerë 340 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Korçë SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është shoqëruar me vërtetimin e realizimit nr.289/1 prot., datë 20.04.2023 nga AK.

Prova nr.13 - Kontrata administrative nr.355/40 prot., datë 18.05.2026, me objekt Shërbimi i fiskalizimit të faturave , me vlerë 1 864 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Korçë SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është duke u zbatuar nga AK aktualisht. -Prova nr.14 - Kontrata administrative nr.12217/7 prot., datë 07.11.2025, me objekt Përmirësimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve, me vlerë 118 880 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor UKT SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është duke u zbatuar nga AK aktualisht.

Prova nr.14/1 ? Marrëveshja noteriale e bashkëpunimit mes BOE të përbërë nga Kreatx SHPK, Jehona Soft SHPK dhe Prisma SHPK, depozituar pranë UKT SHA, për efekt të kontratës administrative me nr.12217/7 prot., datë 07.11.2025, 4 fletë;

Prova nr. 15 – Kontrata administrative nr.16613/16 prot., datë 14.05.2021, me objekt Mirëmbajtjes sistem billingu , me vlerë 5 880 000 Lekë me TVSH, me autoritet kontraktor UKT SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është konfirmuar me vërtetimin e realizimit nr.K-754/1 prot., datë 20.03.2023.

-Prova nr.16 ? Formulari i skualifikimit të Kreatx SHPK. ”

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1988/1 prot, datë 22.05.2026, lidhur me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Kreatx” SHPK kundërshton me anë të ankimit të tij.

II.7. Me anë të shkresës Nr.7491/11 prot., datë 25.06.2026, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr.1988/2 prot., datë 29.06.2026, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, ku konstatohet se ankesa e operatorit ekonomik ankimues është refuzuar me argumentin se:

“[...] Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “Kreax” SHPK, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e saj.”

II.8. Në datë 30.06.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, protokolluar me tonën me nr. 1988/3 prot., datë 01.07.2026, me objekt “Parashtrime për shqyrtimin e ankimit administrativ të datës 19.06.2026 të shoqërisë tregtare Kreatx shpk brenda afatit ligjor, përkundrejt vlerësimit

të paligjshëm të KVO gjatë procedurës së prokurimit publik me REF-83473-04-27-2026, me objekt “Shpenzime për procesin e fiskalizimit për faturat”, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur parashtrime lidhur me aktin e trajtimit të ankesës nga ana e autoritetit kontraktor.

II.9. Gjithashtu, shkresa e mësipërme është dorëzuar pranë KPP-së nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar me tonën me nr. 1988/3 prot., datë 01.07.2026, me objekt *“Parashtrime për shqyrtimin e ankimit administrativ të datës 19.06.2026 të shoqërisë tregtare Kreatx shpk brenda afatit ligjor, përkundrejt vlerësimit të paligjshëm të KVO gjatë procedurës së prokurimit publik me REF-83473-04-27-2026, me objekt “Shpenzime për procesin e fiskalizimit për faturat”, ku operatori ekonomik ankimues ka paraqitur parashtrime lidhur me aktin e trajtimit të ankesës nga ana e autoritetit kontraktor.*

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në zbatim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale, duke kryer “verifikimin e kushteve formale” sipas përcaktimeve të nenit 51 “Verifikimi i kushteve formale”, pika c) “respektimin e afateve ligjore për ankimin”. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:*

III.1.1. Në datën 28.04.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit *“Procedurë e hapur”*, me Nr. REF-83473-04-27-2026, me objekt: *“Shpenzime për procesin e fiskalizimit për faturat”, me fond limit 10,980,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 21.05.2026 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjellës Kanalizime Tiranë.*

III.1.2. Në datën 21.05.2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

III.1.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 05.06.2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | | |
|-------------------------|-----------------------------------|--------------|
| 1. “Kreatx” SHPK | 8,235,000 lekë | Skualifikuar |
| 2. “Prisma” SHPK | 10,100,000 lekë | Kualifikuar |
| 3. “Soft Solution” SHPK | Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike | |

III.1.4. Në datën 12.06.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi Paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku operatori ekonomik “Kreatx” SHPK rezulton i skualifikuar,

III.1.5. Në datën 19.06.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/6853, datë 19.06.2026 dhe me nr. protokoli 1988/2026 datë 22.06.2026 e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

III.1.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1988/1 prot, datë 22.05.2026, lidhur me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Kreatx” SHPK kundërshton me anë të ankimit të tij.

III.1.7. Me anë të shkresës Nr.7491/11 prot., datë 25.06.2026, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr.1988/2 prot., datë 29.06.2026, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, ku konstatohet se ankesa e operatorit ekonomik ankimues është refuzuar me argumentin se:

“[...] Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “Kreax” SHPK, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e saj.”

III.1.8. Në datë 30.06.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, protokolluar me tonën me nr. 1988/3 prot., datë 01.07.2026, me objekt “Parashtrime për shqyrtimin e ankimit administrativ të datës 19.06.2026 të shoqërisë tregtare Kreatx shpk brenda afatit ligjor, përkundrejt vlerësimit të paligjshëm të KVO gjatë procedurës së prokurimit publik me REF-83473-04-27-2026, me objekt “Shpenzime për procesin e fiskalizimit për faturat”, operatori ekonomik

ankimues ka paraqitur parashtrime lidhur me aktin e trajtimit të ankesës nga ana e autoritetit kontraktor.

III.1.9. Gjithashtu, shkresa e mësipërme është dorëzuar pranë KPP-së nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar me tonën me nr. 1988/3 prot., datë 01.07.2026, me objekt *“Parashtrime për shqyrtimin e ankimit administrativ të datës 19.06.2026 të shoqërisë tregtare Kreatx shpk brenda afatit ligjor, përkundrejt vlerësimit të paligjshëm të KVO gjatë procedurës së prokurimit publik me REF-83473-04-27-2026, me objekt “Shpenzime për procesin e fiskalizimit për faturat”, ku operatori ekonomik ankimues ka paraqitur parashtrime lidhur me aktin e trajtimit të ankesës nga ana e autoritetit kontraktor.*

III.1.10. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.”*

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *“1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.*

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme:

a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).”

III.1.11. Në nenin 97 pika 1 dhe 5 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor: a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.”

III.1.12. Në vlerësim të Vendimit Nr. 74, datë 25.06.2025 të Gjykatës Administrative të Apelit,, **Pika III. Vlerësimi i Gjykatës, 31.** Për kushtin tjetër formal të padisë, respektimin e afatit ligjor.....;: “... Praktika gjyqësore e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. (00-2017-927) 670, datë 30.05.2017, konfirmon të njëjtin qëndrim: "... Gjykata Administrative e Shkallës së Parë të Tiranës e ka zbatuar gabim ligjin për përllogaritjen e afatit të prerë të ankimit administrativ. Në këtë pjesë të çështjes, Kolegji konfirmon plotësisht bazueshmërinë në ligj të qëndrimit të Gjykatës Administrative të Apelit, se... edhe afatet e parashikuara nga neni 63 i Ligji për prokurimin publik duhet të interpretohet sikur rregullojnë të gjithë ligjet procedurale, sikur neni 62 i Kodit të Procedurave Administrative apo neni 148, 443 dhe 444 të Kodit të Procedurës Civile. **Sipas gjykatës së apelit, afati i ankimit administrativ, nis të llogaritet gjithmonë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit...**”, si dhe duke u mbështetur në nenin 97 pika 5 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në të cilin përcaktohet se: “5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e ulët monetar siç është procedura e prokurimit objekt ankimi, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është 7 ditë nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të fituesit ose njoftimit të anulimit dhe në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në pikën 5 të aktit rregullator të sipërcituar nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.

III.1.13. Në rastin konkret referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe informacionit të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor rezulton se njoftimi i fituesit paraprak të procedurës së prokurimit objekt ankimi është publikuar me datë 12.06.2026. Ndërkohë, KPP vëren, se me datë 19.06.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2024/6853, datë 19.06.2026 dhe me nr. protokolli 1988/2026 datë 22.06.2026 e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Sa më sipër, KPP gjykon se, ankesat e operatorit ekonomik ankimues, është paraqitur brenda afateve ligjore, pasi nga verifikimi i sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), rezulton se datë 19.06.2026, kur është paraqitur ankesa nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike ndryshe nga argumentimi i autoritetit kontraktor, afati i ankimit ende nuk kishte përfunduar, pasi në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në pikën 5 të nenit 97 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse. Gjithashtu edhe në vlerësim të vendimit të sipërcituar të Gjykatës Adminsitrativë të Apelit **afati i ankimit administrativ, nis të llogaritet gjithmonë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit...**”,

III.1.14. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën

në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor përmes sistemit të ankesave elektronike brenda afatit të parashikuar nga neni 97 pika 5 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në të cilin parashikohet se: “5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatese.” por edhe nga vlerësimi që Gjykata Administrative e Apelit përmes vendimit Nr. 74, datë 25.06.2025 i ka bërë nisjes së llogaritjes së afatit të ankimit administrativ.

Në këtë kuptim KPP gjykon, se ankesa e depozituara me datë 19.06.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, konsiderohen e paraqitur brenda afatit ligjor të ankimit, duke u legjitimuar *ratione temporis*.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “ Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësisë të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuara nga operatori ekonomik ankimues, ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.1.15. Lidhur me vendimin e KSHA- së Nr. 7491/11 prot., datë 25.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1988/2 prot., datë 29.06.2026, të autoritetit kontraktor për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor lidhur me këtë vendimmarrje nuk ka vepruar në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj., përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon, se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale, atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e

vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh.A (Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave). Normativa e parashikuar nga legjislacioni i prokurimit publik mbi afatet e ankimit administrativ rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Procedura përpara autoritetit kontraktor si edhe para KPP, ka natyrën e procedurave të nxitura, pasi autoriteti kontraktor nuk mund të bëhet vetëiniciator i fillimit të procedurave kryesisht. Si rregull, investimi i K.Sh.A është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuara dhe që plotësojnë kushtet formale të ankesës, ku një prej të cilave është dhe respektimi i afateve të ankimit. Pra, komisioni i shqyrtimit të ankesave duke mos marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur, në respektim të afateve të ankimit, ka nxjerrë në këtë mënyrë një akt në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik dhe referuar ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, për këtë arsye ky akt është absolutisht i pavlefshëm dhe nuk prodhon asnjë pasojë ligjore. Për këtë arsye, Komisioni gjykon, se vendimi i KSHA për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK është në kundërshtim të plotë me aktet në fuqi, ndaj do të shpallet absolutisht i pavlefshëm nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi, me arsyen se: *“Se dyti Ak në dokumentat standarte te tenderit perkatesisht ne piken 2.6 te kriterëve te vecante te kualifikimit ka kekruar si me poshte vijon:*

2.6 Operatorët ekonomikë duhet të zoteroje aftësite/certifikimet për veprimtarite dhe teknologjite si mëposhte:

- *Për Fiskalizimin e Fatures. Zgjidhja softëare-ike e ofertuar duhet të jetë e certifikuar për veprimtarine e fiskalizimit, si mëposhte:*

- *Me dhe pa para në dorë;*

- *Pa para në dorë, e-invoice;*

- *Faturë shoqëruese;*

- *Për Sisteme Cloud, në platformen e cila do të ofertohej. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga Drejtoria e Tatimeve dhe AKSHI, prodhuesit e programeve dhe teknologjive që po ofertojnë, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara nga prodhuesit për dhënien e tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se operatori ekonomik Kreatx nuk ka provuar përmbushjen e kriterit 2.6 të Dokumenteve Standarde të Tenderit. Kriteri 2.6 përbën një kriter kualifikimi me karakter formal dhe detyrues, i përcaktuar në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë, sipas të cilit kërkohet paraqitja e certifikimeve të lëshuara nga prodhuesit e programeve dhe*

teknologjive që do të ofrohen, ose nga autoritete të autorizuar prej tyre, për sistemet Cloud dhe platformën teknologjike që do të përdoret për realizimin e kontratës. Ky kriter është vendosur nga Autoriteti Kontraktor për të garantuar që infrastruktura Cloud, shërbimet e hostimit dhe operimi i sistemit të realizohen në mënyrë të autorizuar, të certifikuar dhe në përputhje me standardet teknike dhe ligjore të kërkuara. Rëndësia e tij është argumentuar edhe në dokumentacionin e miratimit të kriterëve të kualifikimit, duke qenë se objekti i kontratës lidhet drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve Cloud ku do të përpunohen, transmetohen dhe ruhen të dhëna operative, konfidenciale dhe të dhëna personale.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se operatori ekonomik nuk ka depozituar certifikimet e kërkuara në DST, por ka paraqitur vetëm një deklaram të vetin, të shoqëruar me referenca në faqe interneti, duke pretenduar se prodhuesi apo ofruesi i platformës nuk aplikon politika certifikimi për partnerët ose përdoruesit e shërbimit. Komisioni vlerëson se një deklaram i tillë nuk përbën dokumentacion provues dhe nuk mund të konsiderohet i barsvlershëm me certifikimet e kërkuara shprehimisht nga Dokumentet e Tenderit. Kërkesa e DST-së është e qartë dhe kërkon paraqitjen e dokumenteve zyrtare të lëshuara nga prodhuesi ose nga autoritete të autorizuar prej tij. Për rrjedhojë, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik nuk përmbush formën dhe përmbajtjen e provës së kërkuar, duke rezultuar në mosplotësim të kriterit të kualifikimit. Gjithashtu, Komisioni vlerëson se kriteri në fjalë lidhet drejtpërdrejt me garantimin e ligjshmërisë, sigurisë dhe vijueshmërisë së shërbimit Cloud që do të ofrohet gjatë zbatimit të kontratës. Certifikimi ose autorizimi nga prodhuesi përbën një garanci objektive se operatori ekonomik disponon të drejtën, kapacitetin teknik dhe mbështetjen e nevojshme për të administruar dhe operuar platformën Cloud në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme.

Mungesa e këtyre certifikimeve krijon pasiguri të konsiderueshme lidhur me:

- ligjshmërinë e përdorimit dhe ofrimit të platformës Cloud;
- disponimin e të drejtave për administrimin dhe konfigurimin e shërbimit;
- aksesin në mbështetjen teknike zyrtare të prodhuesit;
- mundësinë e ndërhyrjeve teknike, përditësimeve dhe zgjidhjes së problematikave gjatë periudhës së kontratës;
- garantimin e vazhdimësisë dhe sigurisë së shërbimit për Autoritetin Kontraktor.

Nga ana tjetër, Komisioni vlerëson se kriteret e kualifikimit janë kritere formale dhe objektive, të cilat duhet të provohen përmes dokumentacionit të kërkuar në momentin e paraqitjes së ofertës. Përmbushja e tyre nuk mund të bazohet në deklaram të njëanshme të operatorit ekonomik dhe as të zëvendësohet me interpretime apo verifikime të mëvonshme nga Autoriteti Kontraktor. Barra e provës për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit i takon ekskluzivisht operatorit ekonomik. Kërkesa që Autoriteti Kontraktor të kryejë verifikime të jashtme pranë prodhuesit të platformës Cloud ose të ndërmarrë hetime shtesë për të provuar ligjshmërinë e përdorimit të shërbimit do të binte në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë, duke krijuar një avantazh të padrejtë për ofertuesin në fjalë në raport me pjesëmarrësit e tjerë të procedurës. Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave arrin në përfundimin se operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin provues të kërkuar për kriterin 2.6 dhe nuk

ka demonstruar në mënyrë të mjaftueshme, objektive dhe të verifikueshme përmbushjen e këtij kriteri.” Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 9 të dokumenteve të tenderit, 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 2.6 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si vijon:

“2.6 Operatorët ekonomikë duhet të zoteroje aftësite/certifikimet për veprimtarite dhe teknologjite si mëposhte:

- *Për Fiskalizimin e Fatures. Zgjidhja softëare-ike e ofertuar duhet të jete e certifikuar për veprimtarine e fiskalizimit, si mëposhte:*
 - *Me dhe pa para në dorë;*
 - *Pa para në dorë, e-invoice;*
 - *Faturë shoqëruese;*
- *Për Sisteme Cloud, në platformen e cila do të ofertohej.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga Drejtoria e Tatimeve dhe AKSHI, prodhuesit e programeve dhe teknologjive që po ofertojnë, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara nga prodhuesit për dhënien e tyre.”

III.2.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë “Për zgjidhjen e certifikuar softëareike të fiskalizimit dhe për platformën OVH Cloud ku hostohet fiskalizimi”, datë 21.05.2026, me përmbajtje si vijon: “Në shtojcat dhe nr.9 të DST, ku përcaktohen kriteret kualifikuese, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se, **2.6 Operatorët ekonomikë duhet të zoteroje aftësite/certifikimet për veprimtarite dhe teknologjite si mëposhte:**
 - *Për Fiskalizimin e Fatures. Zgjidhja softëare-ike e ofertuar duhet të jete e certifikuar për veprimtarine e fiskalizimit, si mëposhte:*
 - *Me dhe pa para në dorë;*
 - *Pa para në dorë, e-invoice;*
 - *Faturë shoqëruese;*
 - *Për Sisteme Cloud, në platformen e cila do të ofertohej.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga Drejtoria e Tatimeve dhe AKSHI, prodhuesit e programeve dhe teknologjive që po ofertojnë, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara nga prodhuesit për dhënien e tyre

Për sa më lart, shoqëria tregtare Kreatx SHPK, me NUIS nr.L12121023B, me administrator z. Enor Nakuçi, deklaroi se, disponon në cilësinë e prodhuesit zgjidhjen softëareike të fiskalizimit, markën Oxana të regjistruar dhe certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale

të regjistruar me nr. 2111, me afat 11.12.2019-11.12.2029. Marka Oxana është regjistruar si zgjidhje softëareike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit me nr.serial 80-2021, datë 25.11.2021, versioni 3.0, me kod [...].

Zgjidhja softëareike është e certifikuar dhe e regjistruar nga AKSHI dhe DPT për të gjitha shërbimet e fiskalizimit si më lart:

- Me dhe pa para në dorë;
- Pa para në dorë, e-invoice;
- Faturë shoqëruese;

Ndërkohë, në lidhje me platformën cloud rezulton se, shërbimi i fiskalizimit përmes zgjidhjes softëareike Oxana hostohet në platformën e njohur OVH Cloud. Kjo platformë për shkak të politikës tregtare të OVH Cloud nuk ofron certifikata për cloudin në raport me partnerët e saj tregtarë, sic rezulton që të jetë shoqëria tregtare Kreatx SHPK.

Në këto kushte, shoqëria tregtare Kreatx SHPK, me NUIS me nr. L12121023B, me administrator Z.E.N, deklaron se jemi partnerë zyrtarë të OVH Cloud i cili i përmbush të gjitha kërkesat e sigurisë dhe sipas DST. Kjo gjë vërtetohet me pamjet e mëposhtme:

(printscreen të ëeb). ”

Serverat e OVH Cloud janë të sigurtë në drejtim të mbrojtjes së të dhënave dhe sigurisë kibernetike dhe janë të pajisur me ISO 27001. Zona gjeografike ku shtrihet OVH Cloud është në Gjermani, Zvicër, Itali, Portugali, Austri, Belgjikë, Poloni dhe Danimarkë, etj. Parametrat e serverave në cloud janë publikë, e mund të verifikohen lehtësisht në ëebpage e OVH Cloud.

Verifikimet për shoqërinë tonë tregtare mund të kryhen në linkun e mëposhtëm: https://partner.ovhcloud.com/en/partner/kreatx/?_gl=1*vivs3h*_gcl_au*MTY4OTQzMTQzOS4xNzY1OTg1ODAx Linku është aksesuar më datë: 20.05.2026, ora 12:48.

Sjellim në vëmendje të UKT SHA se, në kushtet kur certifikata për partneritetin me OVH Cloud është e pamundur për t'u administruar dhe siguruar nga partneri zyrtar Kreatx shpk, për shkak se nuk ekziston një e tillë, në zbatim të pikës 3, të nenit 80, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikë së Shqipërisë, informacioni i dhënë në faqen zyrtare të OVH Cloud për partneritetin me Kreatx shpk, përbën fakt të njohur botërisht dhe nuk ka nevojë që të provohet më tej me prova të tjera apo certifikata të ndryshme. Infrastruktura në cloud e OVH Cloud është publike dhe duke qenë e publikuar në faqen e zyrtare të saj, përbën fakt të njohur botërisht. ”

III.2.3. Në ankesën e tij operatori ekonomik ankimes pretendon: Shkaku i dytë i skualifikimit se, Kreatx SHPK nuk plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.6 të shtojcës nr.9 të DST, për aftësitë/certifikimet për veprimtaritë dhe teknologjitë për sisteme Cloud në platformën që do të ofertohej.

Në pikën 2.6 të shtojcës nr.9 të DST AK ka përcaktuar kriterin kualifikues me këtë përmbajtje: 2.6 Operatorët ekonomikë duhet të zoteroje aftësitë/certifikimet për veprimtaritë dhe teknologjitë si mëposhte:- Për Fiskalizimin e Fatures. Zgjidhja softëare-ike e ofertuar duhet të jete e certifikuar për veprimtarinë e fiskalizimit, si mëposhte: Me dhe pa para në dorë; Pa para në dorë, e-invoice; Faturë shoqëruese; - Për Sisteme Cloud, në platformën e cila do të ofertohej. Për

përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga Drejtoria e Tatimeve dhe AKSHI, prodhuesit e programeve dhe teknologjive që po ofertojnë, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara nga prodhuesit për dhënien e tyre.

Për të përmbushur këtë kriter kualifikues, Kreatx SHPK ka ngarkuar në SPE deklaratë për zgjidhjen softëareike të fiskalizimit dhe platformën cloud ku ajo hostohet, deklaratë se disponon markën Oxana të regjistruar pranë DPPI si zgjidhje softëareike të fiskalizimit, certifikatën e regjistrimit të markës Oxana versioni 3.0, si dhe certifikatën e regjistrimit të zgjidhjes softëareike të fiskalizimit pranë AKSHI dhe DPT Oxana versioni 3.0.

Mes këtyre dokumentave, në deklaratën për zgjidhjen softëareike të fiskalizimit dhe të platformës OVH Cloud ku hostohet kjo zgjidhje softëareike fiskalizimi Kreatx SHPK deklaroi shprehimisht se: Në lidhje me platformën cloud rezulton se, shërbimi fiskalizimit përmes zgjidhjes softëareike Oxana hostohet në platformën e njohur OVH Cloud. Kjo platformë për shkak të politikës tregtare të OVH Cloud nuk ofron certifikata për cloudin në raport me partnerët e saj tregtarë, siç rezulton që të jetë shoqëria tregtare Kreatx SHPK. Në këto kushte, shoqëria tregtare Kreatx SHPK, me NUIS me nr. L12121023B, me administrator z. Enor Nakuçi, deklaroi se jemi partnerë zyrtarë të OVH Cloud, i cili i përmbush të gjitha kërkesat e sigurisë dhe sipas DST. Kjo gjë vërtetohet me pamjet e mëposhtme (...) Serverat e OVH Cloud janë të sigurtë në drejtim të mbrojtjes së të dhënave dhe sigurisë kibernetike dhe janë të pajisur me ISO 27001. Zona gjeografike ku shtrihet OVH Cloud është në Gjermani, Zvicër, Itali, Portugali, Austri, Belgjikë, Poloni dhe Danimarkë, etj. Parametrat e serverave në cloud janë publikë, e mund të verifikohen lehtësisht në ëebpage e OVH Cloud. Verifikimet për shoqërinë tonë tregtare mund të kryhen në linkun e mëposhtëm: https://partner.ovhcloud.com/en/partner/kreatx/?_gl=1*vivs3h*_gcl_au*MTY4OTQzMTQzOS4xNzY1OTg1ODA1 Linku është aksesuar më datë: 20.05.2026, ora 12:48. Sjellim në vëmendje të UKT SHA se, në kushtet kur certifikata për partneritetin me OVH Cloud është e pamundur për t'u administruar dhe siguruar nga partneri zyrtar Kreatx SHPK, për shkak se nuk ekziston një e tillë, në zbatim të pikës 3, të nenit 80, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, informacioni i dhënë në faqen zyrtare të OVH Cloud [për partneritetin me Kreatx SHPK, përbën fakt të njohur botërisht dhe nuk ka nevojë që të provohet më tej me prova të tjera apo certifikata të ndryshme. Infrastruktura në cloud e OVH Cloud është publike dhe duke qenë e publikuar në faqen e zyrtare të saj, përbën fakt të njohur botërisht.

Lidhur me sa ka parashtruar Kreatx SHPK më lart, KVO pranë UKT SHA nuk i ka marrë në konsideratë provat e mësipërme, me argumentin e mëposhtëm: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se operatori ekonomik Kreatx nuk ka provuar përmbushjen e kriterit 2.6 të Dokumenteve Standarde të Tenderit. Kriteri 2.6 përbën një kriter kualifikimi me karakter formal dhe detyrues, i përcaktuar në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë, sipas të cilit kërkohet paraqitja e certifikimeve të lëshuara nga prodhuesit e programeve dhe teknologjive që do të ofrohen, ose nga autoritete të autorizuar prej tyre, për sistemet Cloud dhe platformën teknologjike që do të përdoret për realizimin e kontratës. Ky kriter është vendosur nga Autoriteti Kontraktor për të garantuar që infrastruktura Cloud, shërbimet e hostimit dhe operimi

i sistemit të realizohen në mënyrë të autorizuar, të certifikuar dhe në përputhje me standardet teknike dhe ligjore të kërkuara. Rëndësia e tij është argumentuar edhe në dokumentacionin e miratimit të kriterëve të kualifikimit, duke qenë se objekti i kontratës lidhet drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve Cloud ku do të përpunohen, transmetohen dhe ruhen të dhëna operative, konfidenciale dhe të dhëna personale. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se operatori ekonomik nuk ka depozituar certifikimet e kërkuara në DST, por ka paraqitur vetëm një deklaram të vetin, të shoqëruar me referenca në faqe interneti, duke pretenduar se prodhuesi apo ofruesi i platformës nuk aplikon politika certifikimi për partnerët ose përdoruesit e shërbimit. Komisioni vlerëson se një deklaram i tillë nuk përbën dokumentacion provues dhe nuk mund të konsiderohet i barasvlerëshëm me certifikimet e kërkuara shprehimisht nga Dokumentet e Tenderit. Kërkesa e DST-së është e qartë dhe kërkon paraqitjen e dokumenteve zyrtare të lëshuara nga prodhuesi ose nga autoritete të autorizuar prej tij. Për rrjedhojë, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik nuk përmbush formën dhe përmbajtjen e provës së kërkuar, duke rezultuar në mosplotësim të kriterit të kualifikimit. (...) Barra e provës për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit i takon ekskluzivisht operatorit ekonomik. Vlerësimi i mësipërm i KVO pranë UKT SHA është në kundërshtim flagrant me LPP, RRPP dhe KPA për arsyet që renditen si më poshtë:

1.Në ndryshim nga çfarë pretendon KVO, Kreatx SHPK i ka provuar kapacitetet e saj se shërbimi i fiskalizimit Oxana versioni 3.0 hostohet në OVH cloud. Ky cloud provider është tejet i njohur ndërkombëtarisht, pasi zotëron zyra përfaqësimi në të gjithë rruzullin tokësor, sipas një shpërndarje gjeografike në çdo kontinent, që është publike botërisht në faqen e tij zyrtare. Po kaq i njohur botërisht është edhe fakti se, ky partner nuk lëshon certifikime për OE që përdorin shërbimet e tij. Prandaj, politika e tij është publikimi i partnerëve në faqen zyrtare dhe çdokush mund të njihet me këtë informacion publik vetëm me një klikim.

2.Kreatx SHPK i ka demonstruar AK dhe KVO me prova konkrete siç është deklarata me shkrim se, është partner zyrtar dhe i avancuar i OVH Cloud dhe kjo gjë verifikohet lehtësisht në faqen zyrtare të OVH Cloud, respektivisht në linkun: https://partner.ovhcloud.com/en/partner/kreatx/?_gl=1*vivs3h*_gcl_au*MTY4OTQzMTQzOS4xNzY1OTg1ODAl

3.Kreatx SHPK ka përmbushur barrën e provës në kuptim të nenit 80, pika 3, të KPA, për sa kohë që i gjithë informacioni, dokumentacioni dhe shërbimet që marrim në OVH cloud janë publike. Kështu, neni 80, pika 3, i KPA, përcakton se, Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme. Në kushtet kur të gjitha faqet zyrtare të subjekteve tregtare gjenden lehtësisht në internet dhe ato përbëjnë fakte të njohura botërisht, pa pasur nevojë për të paraqitur dokumentacion apo certifikime shtesë për AK. Kështu, Kreatx SHPK e ka përmbushur me sukses barrën e provës se, cloudi me të cilin operon OE është jo vetëm i certifikuar dhe i sigurtë, por kënaq edhe kërkesatapo nevojat e AK për prokurimin publik, duke e informuar KVO për sigurinë e të dhënave, për mbrojtjen e të dhënave që ofron OVH Cloud, parametrat e serverave në cloud, vendndodhjen e tyre, etj. Gjithashtu, informacioni i dhënë nga Kreatx SHPK provon njëherazi se,

OVH Cloud operon dhe në vendet e BE dhe është certifikuar si cloud provider për servera publikë dhe privatë njëkohësisht me një standard të lartë shërbimi.

4. Skualifikimi i Kreatx SHPK për këtë kriter kualifikues nga KVO është gjithashtu joproporcional dhe në kundërshtim me nenin 12 të KPA. Duke kërkuar certifikime të panevojshme për OVH Cloud, ndonëse ky i fundit nuk lëshon deklarata apo certifikata për partnerët e tij, AK dhe KVO e kanë vendosur Kreatx SHPK në një situatë të pazakontë dhe i kanë ngarkuar OE ofertues një barrë joproporcionale në procedurën administrative. Për më tepër, karakteri joproporcional i barrës dallohet edhe nga fakti se, KVO nuk ka kërkuar as kërkesë për sqarim gjatë vlerësimit të ofertës së Kreatx SHPK, por ka vjuar direkt me skualifikimin e ofertës së tij. Kjo situatë shton edhe më tej, paligjshmërinë e veprimeve të AK dhe KVO.

5. Skualifikimi i Kreatx SHPK nga KVO pranë UKT SHA është bazuar mbi një kriter kualifikues të paqartë dhe të hartuar në kundërshtim me LPP dhe RRPP, pasi edhe në procesverbalin argumentues të DST lloji i certifikimit të kërkuar është i paidentifikueshëm. Në këtë drejtim, edhe sikur të paraqitej certifikatë, OE nuk e kanë pasur informacionin se çfarë certifikate duhet të vendosnin në dispozicion të AK për të përmbushur kriterin kualifikues. Vlen të theksojmë se, me interes për ankimin administrativ do të ishte edhe verifikimi nga KPP për mënyrën sesi e ka plotësuar OE fitues i prokurimit këtë kriter kualifikues. Pra, me çfarë lloj certifikate?

6. Skualifikimi i Kreatx SHPK nga KVO për këtë kriter kualifikues bie ndesh me parimin e transparencës dhe me praktikën administrative të prokurimit publik. Nisur nga fakti se shërbimet në cloud blihen/kontraktohen në shumicën e rasteve online, duke pranuar kriteret e shërbimeve të cloud providers, praktika administrative e prokurimit publik në këto raste, ka qenë paraqitja e deklaratave me shkrim, ku të jepen të dhënat dhe linket e cloud provoders, e ku të verifikohen kërkesat e tij lidhur me standardet ligjore dhe parametrat teknikë. Në praktikën administrative të dhënat janë verifikuar gjithnjë në faqet zyrtare të cloud providers, pa nevojën për të depozituar certifikata partneriteti apo kontrata me shkrim. Kjo praktikë është më transparente, siguron konkurrencën dhe është më e vlefshme për AK për efekt të verifikimeve që mund të kryhen nga AK. Duke mos ndjekur praktikën e shëndoshë administrative sipas këtij paragrafi, vendimi i KVO për skualifikimin e ofertës së Kreatx SHPK është rezultat i ushtrimit të paligjshëm të diskrecionit nga ana e organit publik, ndesh me sa parashikon neni 11 i KPA.

Nga sa argumentohet më lart, vendimi i KVO për skualifikimin e ofertës ekonomike të Kreatx SHPK është i paligjshëm dhe duhet të anulohet nga KSHA dhe KPP. Shkaku i tretë i skualifikimit se, Kreatx SHPK nuk plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në shkronjën d , të pikës 2.7 të shtojcës nr.9 të DST, për punonjësit e certifikuar.

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.2.5. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 2 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë

pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi.

III.2.7. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP vëren se në pikën 2.6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë duhet të zotërojnë aftësitë/certifikimet për veprimtaritë dhe teknologjitë si më poshtë: - Për Fiskalizimin e Faturës si dhe Për Sisteme Cloud, në platformën e cila do të ofertohej. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga Drejtoria e Tatimeve dhe AKSHI, prodhuesit e programeve dhe teknologjive që po ofertojnë, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara nga prodhuesit për dhënien e tyre.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, konkretisht për pikën lidhur me certifikimet për Sisteme Cloud, në platformën e cila do të ofertohej nuk ka dorëzuar asnjë certifikim sipas kërkesave të kriterit të kualifikimit, por ka paraqitur një deklaratë në të cilën citon se është partner i prodhuesit OVH dhe se ky i fundit sipas politikave të tij nuk lëshon certifikime për partnerët e tij, ndërkohë nuk ka paraqitur asnjë dokument provues të këtij fakti, përveç një linku web për të vërtetuar se është partner i OVH Cloud. Komisioni i Prokurimit Publik si një organ mbi palët, gjykon mbi themelin e pretendimeve lidhur me arsyet e skualifikimit të ankimuesve apo pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë vetëm mbi bazën e kriterëve të hartuara nga autoritetet kontraktore dhe dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Në këtë kuadër, KPP vëren se, vetë ankimuesi në ankimin e tij pranon faktin se për platformën OVH Cloud, nuk ka paraqitur asnjë dokument provues certifikimi, ndryshe nga sa përcaktohet në dokumentat e tenderit, pika 2.6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, por pretendon se nga verifikimi në faqen web rezulton partner zyrtar i prodhuesit OVH Cloud dhe se ky i fundit nuk lëshon certifikime.

Gjithashtu, KPP vëren se autoriteti kontraktor bazuar në procesverablin e argumentimit të kriterëve të veçanta për kualifikim e ka argumentuar si vijon: *“Sistemet kryesore ne projekt jane kerkuar ne Cloud. Lidhur me zbatimin dhe mirembajtjen e sistemeve te mesiperme, prodhuesit e programeve informatike te mirenjohur nderkombetarisht, kane ndertuar programe trajnimi dhe kontrolli te shoqerive te cilat mundet te kryejne sherbime qe lidhen me zbatimit apo mirembajtjen e ketyre sistemeve. Ne kuader te ketyre programeve te certifikimit, prodhuesit vendosin kriteret teknike nga pikepamja organizative, burimet njerezore te trajnuara/certifikuara per keto teknologji si dhe per procedurat e brendshme apo administrimin e informacionit te shoqerive. Keto programe/kushte certifikimi ndertohen nga vete prodhuesit dhe ata ne kete menyre marrin persiper cilesine e sherbimeve te ofruara nga shoqerite. Ne shume raste, kalimi i certifikimeve i kualifikon shoqerite e IT si te autorizuar apo jo prej tyre per realizimin e sherbimeve te nderhyrjes, permiresimit apo perditesimit te sistemeve. Nese shoqerite nuk kane certifikime te prodhuesit (per infrastrukture) cdo nderhyrje ne sistem rezikon perfundimin e kushteve te garancise apo te mirembajtjes se prodhuesit. Per kete, certifikimi jo vetem perbejne nje nevojte per garantimin e cilesise se sherbimit*

por ato nga ana tjetër janë direkt të lidhura edhe me kërkesat e prodhuesve për mirembajtjen. Nderhyrje në sistem nga shoqëri të pa-certifikuara mundet të demotojë vetë sistemin, të dhenat që mbahen në sistem dhe/ose në kuadrin e sigurisë së informacionit mundet të behet shkak për aksesin apo demtimin e informacionit në persona apo drejtime të paautorizuara. Këtu duhet pasqyruar fakti i sensibilitetit të të dhënave që mbahen në cloud, siguria në të dhëna financiare si dhe shpejtësia me të cilën kërkohet të operohen dhe procesohen të dhënat. Kjo kërkesë i shërben AK për të garantuar që Operatori Ekonomik ka mbështetjen e prodhuesit për të garantuar cilësinë e produkteve dhe furnizimin e tyre në kohë për përmbushjen me sukses të kontratës, duke garantuar funksionimin e sistemeve në kushtet e garancisë përgjate të gjithë periudhës së kontratës. Për më shumë, certifikimet e mesipërme, garantojnë autoritetin Kontraktor që shërbimet e përfshira në kontratë do të levrohen janë në përputhje me kërkesat e shoqërive prodhuese.”

Pra, për sa i përket elementit provues të kërkesës për Sisteme Cloud, në platformën e cila do të ofertohej (certifikimet) autoriteti kontraktor në mënyrë eksplicite ka kërkuar që për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga Drejtoria e Tatimeve dhe AKSHI, prodhuesit e programeve dhe teknologjive që po ofertojnë, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara nga prodhuesit për dhënien e tyre dhe në asnjë moment nuk ka parashikuar deklaratime në faqen Eëb të prodhuesit. Sikurse kemi cituar më lart në këtë vendim, KPP si organ mbi palët në shqyrtimin e ankesave i qëndron strikt kriterëve të hartuara nga autoritetet kontraktore pasi çdo vlerësim në hamendësim apo tejkalim të tyre është në kundërshtim të plotë me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, cënon parimin e barazisë dhe konkurrencës së drejtë si dhe besueshmërinë e vetë procesit administrativ.

Vlen të theksojmë se, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

III.2.8. Gjithashtu, Komisioni sqaron, se nëse operatori ekonomik do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet se “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” Gjithashtu,

kuadri ligjor parashikon një sërë elementesh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se *“1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.*

Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...].

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK për skualifikimin e tij të padrejtë nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron, dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur”*, me Nr. REF-83473-04-27-2026, me objekt: *“Shpenzime për procesin e fiskalizimit për faturat”*, me fond limit 10,980,000 lekë (pa

tvsh), zhvilluar në datë 21.05.2026 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjellës Kanalizime Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kreatx” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Nertil Kanina

Nënkryetar
Gjergj Mersini

